

1 E martë, 13 shkurt 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Konferencë mbi Ecurinë e Çështjes]

4 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

5 [I akuzuari Shala paraqitet përmes

6 videolidhjes]

7 --- Seanca fillon në orën 10.05

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mirëmëngjes, të gjithëve
9 brenda sallës së gjyqit dhe jashtë saj.

10 Ju kërkoj ndjesë për pesë minutat e vonesës. Kemi pasur
11 një problem teknik.

12 Znj. Sekretare, ju lutem lajmëroni numrin e çështjes.

13 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
14 kjo është çështja KSC-BC-2023-10, Prokurori i Specializuar
15 kundër Sabit Januzit, Ismet Bahtijarit dhe Haxhi Shalës.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj.
17 Sekretare.

18 Tani do t'ju kërkoj palëve dhe pjesëmarrësve që të
19 paraqesin veten duke filluar me zyrën e Prokurorit të
20 Specializuar.

21 Znj. Prokurore, ju e keni fjalën.

22 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, ne kemi
23 ndihmësen e çështjes Aniko Boldog, Prokurorin e Lartë Nathan
24 Quick dhe unë si Prokurore, Taz Shahabuddin.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Të kaloj nga pala

1 Mbrojtëse. Së pari me mbrojtësin e z. Januzi.

2 Mikrofonin, ju lutem.

3 Z. REES: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, unë jam Jonathan
4 Rees, Mbrojtës i Specializuar për z. Januzi, i ndihmuar nga
5 Huw Bowden dhe Muharrem Halilaj.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Rees.

7 Tani shkoj te Mbrojtja e z. Bahtijari.

8 ZNJ. GERRY: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Mirëdita, i
9 nderuar Gjykatës. Unë jam Dr. Felicity Gerry. Jam këtu në emër
10 të z. Bahtijari si Mbrojtëse e tij.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj. Gerry.

12 ZNJ. GERRY: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Unë jam
13 doktoreshë Gerry dhe jo zonja.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj. Gerry.

15 Dakord.

16 ZNJ. GERRY: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Ju
17 falënderoj. Unë kam dëshirë që të njihem si doktoresha Gerry.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Dhe e shoh që -- tani do të
19 them që z. Bahtijari është i pranishëm në sallën e gjyqit dhe
20 kërkesa e tij e mëparshme është e tejkaluar.

21 Tani i kthehem Mbrojtjes së z. Shala.

22 Z. CADMAN: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Mirëdita.

23 Tony Cadbun [Sipas përkthimit] Mbrojtësi i Specializuar për z.
24 Haxhi Shala dhe bashkëmbrojtësi, John Cubbon.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Cadman.

1 Tani vërej që edhe z. Shala merr pjesë me videolidhje në këtë
2 Konferencë të Ecurisë së Çështjes.

3 Tani, Zyra Administrative. Z. Nilsson, ju e keni fjalën.

4 Z. NILSSON: [Përkthim] Jam Jona Nilsson, përfaqësues i
5 Zyrës Administrative i ditës së sotme.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

7 Dhe për procesverbal jam Nicolas Guillou, Gjykatës i
8 Procedurës Paraprake për këtë çështje.

9 Në datën 8 shkurt unë caktova këtë Konferencë të katërt
10 mbi Ecurinë e Çështjes. Synimi im është për të parë ecurinë,
11 për të organizuar shkëmbimet midis palëve për të përgatitur sa
12 më shpejt gjykimin.

13 Në mënyrë të veçantë, dëshiroj të diskutojmë, së pari,
14 çështjen e financimit të ekipeve të Mbrojtjes nga Ministria e
15 Drejtësisë në Kosovë, çështje e ngritur nga të gjitha ekipet e
16 Mbrojtjes në parashtrimet e tyre me shkrim. Dhe më pas
17 nxjerrjen e materialeve provë, ecurinë e hetimeve të
18 Prokurorit të Specializuar, pikat e pajtimit mbi aspekte
19 juridike dhe faktike, ecurinë e hetimeve të Mbrojtjes, kur
20 parashikohet që të transmetohet dosja gjyqësore dhe kur do të
21 jenë të gatshme palët për gjykim, dhe në fund ndonjë çështje
22 tjetër që dëshirojnë palët që të ngrenë.

23 I falënderoj palët për parashtrimet e tyre përpara kësaj
24 Konference mbi Ecurinë e Çështjes. Dhe si zakonisht do t'ju
25 kërkoj palëve dhe Zyrës Administrative që pikëpamjet e tyre

1 t'i paraqesin në mënyrë sa më të shkurt për secilën prej
2 pikave të rendit të ditës, pika të cilat unë do t'i diskutoj
3 një nga një.

4 I rikujtoj palët dhe Zyrën Administrative që në qoftë se
5 në ndonjë prej parashtrimeve parashikon nxjerrjen e
6 informacione konfidenciale duhet të kemi njoftim paraprak me
7 qëllim që të kalojmë në seancë private ose të mbyllur.

8 Para se të kalojmë në pikën të rendit të ditës dua të
9 dëgjoj nga palët dhe Zyra Administrative lidhur me çështjen e
10 ngritur nga ekipet e Mbrojtjes në parashtrimet e tyre me
11 shkrim, konkretisht çështjen e financimit të ekipeve të
12 mbrojtjes.

13 Në parashtrimet për këtë Konferencë të Ecurisë, Mbrojtja
14 e Januzit ka ngritur çështjen e dështimit nga ana e Ministrisë
15 së Drejtësisë së Kosovës si rezultatit i së cilit është -
16 rezultat i së cilit është që ne nuk kemi financim dhe nuk kemi
17 afat dhe përcjelljen e kësaj çështje.

18 Mbrojtja e Bahtijarit ka thënë që janë bërë një numër
19 kërkesash Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës për financim.
20 Ishte caktuar të mbahej një takim për këtë çështje muajin e
21 shkuar por ky u shty pa asnjë konfirmim se do të ketë
22 financim.

23 Dje me email jam njoftuar që një takim ishte parashikuar
24 që të mbahej gjatë ditës së sotme dhe prandaj do t'i kërkoj
25 avokates që të na përditësojë lidhur me këtë çështje.

1 Mbrojtja e Shalës ka thënë se hetimet e saj do të varen
2 nga garantimi i fondeve nga ana e Ministrisë së Drejtësisë në
3 Kosovë .

4 Dhe prandaj dua të dëgjoj nga secila prej ekipeve të
5 Mbrojtjes sesi është situata aktuale, a ka ndonjë gjë të re,
6 dhe nëse ka ndonjë mundësi për zgjidhjen sa më shpejt të kësaj
7 çështje. U kërkoj palëve të Mbrojtjes që të tregojnë nëse këtë
8 çështje e kanë ngritur me Zyrën Administrative dhe nëse po,
9 çfarë zgjidhjesh kanë diskutuar. Në mënyre të veçantë i kërkoj
10 Mbrojtjes së Bahtijarit për të treguar se cila është arsyeja e
11 kërkesës së saj për pezullimin e të tërë procedurës për një
12 periudhë njëmuajore.

13 Së pari po ja jap fjalën Mbrojtjes së z. Januzi. Z. Rees,
14 ju e keni fjalën.

15 Z. REES: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

16 I nderuar Gjykatës, Ligji mbi Mbrojtjen Ligjore dhe
17 Mbrojtjen e Personave të Akuzuar përpara Dhomave të
18 Specializuara të Kosovës, Ligji 05/L-054, i kërkon shtetit
19 kosovar që t'i mbështesë nga pikëpamja financiare të akuzuarit
20 dhe për të -- pra, të gjithë personat të cilët akuzohen
21 përpara Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe kjo përmes
22 legjislacionit dytësor të Ministrisë së Drejtësisë. Ky ligj e
23 pranon në hyrjen e tij sakrificën dhe kontributin që ka bërë
24 Ushtria Çlirimtare e Kosovës në sigurimin e lirisë për
25 qytetarët e Kosovës. Dhe e dyta, e thotë përsëri në këtë

1 parahyrje, këtë angazhimin, pra angazhimin e Republikës së
2 Kosovës për të mbrojtur të drejtat e të gjithë qytetarëve të
3 saj.

4 Legjislacioni dytësor që vjen nga Ligji 05/L-054 dhe kjo
5 është Udhëzimi Administrativ nr. 8/2022. Sipas këtij udhëzimi
6 Mbrojtja e z. Januzi e ka bërë kërkesë në përputhje me
7 kriteret e saj me 4 dhjetor 2023. Sipas kriterëve, Ministria e
8 Drejtësisë duhet të krijojë një komision për t'i dhënë
9 përgjigje kësaj kërkesë brenda 10 ditësh.

10 Ne i kemi kërkuar vazhdimisht Ministrisë së Drejtësisë që
11 ta trajtojë këtë kërkesë së pari brenda 10 ditëve të
12 parashikuara dhe më pas këtë e kemi bërë përmes një
13 korrespondence *inter partes* ku Ministria e Drejtësisë kërkoi
14 që ta shtyjmë këtë çështje ndërkohë që do të zgjidhin çështjen
15 e mungesës së numrit të duhur të personave që merrnin pjesë në
16 këtë komision. Ne na janë dhënë disa data kur do të takohet ky
17 komision dhe herë pas herë -- dhe pastaj në çdo rast na është
18 thënë që do të vonohet më tutje. Kjo ka vazhduar gjatë të
19 gjithë dhjetorit, janarit dhe shkurtit dhe deri në javën e
20 shkuar.

21 Ne jemi përpjekur që të vazhdojmë bashkëpunimin tonë dhe
22 i kemi besuar kur na kanë thënë që do të zgjidhej kjo çështje,
23 por në fakt kjo është kosto për ne, është dështim për ne pasi
24 edhe sot që ne ndodhemi këtu ende nuk mbajtur, nuk na është
25 komunikuar ndonjë vendim i ndonjë takimi.

1 Ju, të nderuar Gjykatës, na kërkuat që t'ju përditësojmë,
2 sikur ne mendojmë se do të zgjidhej kjo çështje. Unë nuk mund
3 ta jap dot këtë. Unë mund t'ju kaloj juve, i nderuar Gjykatës,
4 vetëm çfarë na kanë thënë në të shkuarën, që na kanë thënë që
5 çështja po diskutohet urgjentisht, dhe më pas kemi marrë vesh
6 që është shtyrë dhe është shtyrë vazhdimisht. Pra, unë nuk jam
7 në gjendje që të tregoj një afat, i nderuar Gjykatës.

8 Unë mund të them që na kanë thënë që do të mbahet një
9 takim i ri gjatë kësaj jave. A do të mbahet apo jo unë nuk e
10 di.

11 Megjithatë, juve i nderuar Gjykatës, unë do t'ju kërkoja
12 juve që të na ndihmoni në mënyrë konstruktive për të vazhduar
13 më tutje me këtë çështje. Dhe kjo është si më poshtë: Është që
14 ta udhëzoni Ministrinë e Drejtësisë që të përmbushë detyrimet
15 e saj ligjore sipas Ligjit 05/L-054 dhe Udhëzimin
16 Administrativ të Ministrisë së Drejtësisë 08/2022 që ishte në
17 fuqi në dhjetor të 2023 kur u bë kërkesa për mbulimin e kostos
18 së mbrojtjes ligjore.

19 Unë mendoj që është brenda juridiksionit të Dhomave të
20 Specializuara dhe në fakt unë mendoj që është kompetencë
21 ekskluzive e Dhomave të Specializuara për shkak se Ligji 05/L-
22 54 dhe Udhëzimi Administrativ kanë të bëjnë vetëm me proceset
23 përpara Dhomave të Specializuara. [E pakuptueshme] asnjë
24 proces tjetër gjyqësor. Kjo është Gjykata e cila ka
25 juridiksionin kryesor për procedurat apo proceset përpara saj.

1 Pra, unë i kërkoj Trupit Gjykses që këtë, pikërisht këtë
2 t'i thotë Ministrisë së Drejtësisë.

3 Në qoftë se Gjykata nuk mundet ta bëjë këtë gjë apo nuk
4 dëshiron ta bëjë këtë gjë dhe unë do t'ju kërkoja që në qoftë
5 se ju e bëni këtë udhëzim, Ministrisë së Drejtësisë t'i
6 paraqitni, t'i vendosni një afat, afat urgjent, pra,
7 Ministrisë së Drejtësisë dhe në qoftë se nuk zbatohet ky afat
8 mua më duket që rezultati do të ishte që këtë çështje ta
9 dërgojmë në Dhomën Kushtetuese.

10 Edhe në këtë rast, ne do t'ju kërkonim Trupit Gjykses që
11 të na ndihmojë që kjo çështje të zgjidhet sa më shpejt që të
12 jetë e mundur duke iu referuar apo duke e çuar çështjen tek
13 Dhoma Kushtetuese vetë nga Trupi Gjykses këtu. Pra, me qëllim
14 që ata të mund ta ndjekin çështjen e moszbatimit të angazhimit
15 që ka Ministria e Drejtësisë sipas Ligjit 05/L-54 dhe
16 Udhëzimit Administrativ 08/2022, e cila vazhdon, që është në
17 fuqi që nga dhjetori 2023 dhe vazhdon dhe sot e kësaj dite.

18 Këto janë parashtrimet tona dhe shpresoj që të, sa më
19 shpejt që të jetë e mundur të mund ta tejkalojmë, ta kalojmë
20 këtë çështje dhe të përqendrohemi në çështje të tjera më të
21 rëndësishme.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Rees.

23 Tani ia jap fjalën Mbrojtjes së Bahtijarit. Dr. Gerry.

24 ZNJ. GERRY: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] I nderuar,
25 për ta përshpejtuar këtë, a mund të mbështes parashtrimin e z.

1 Rees dhe bëj të njëjtën kërkesën në emër të z. Bahtijari?

2 Si përgjigje ndaj pyetjes suaj, i nderuar Gjykatës, kur
3 hape këtë çështje ne jemi në të njëjtën gjendje. Ne i kemi
4 bërë një numër kërkesash Ministrisë së Drejtësisë për t'u
5 dhënë përgjigje kërkesës sonë për financim. Dhe kur u bë e
6 qartë që ky takim nuk do të mbahej gjatë javës së shkuar, pra
7 takimi i këtij komisioni, unë njoftova vetë Zyrën
8 Administrative se kishte një problem. Të njëjtën gjë bëra edhe
9 me Zyrën e Prokurorisë së Specializuar dhe shpresoj që këto
10 mesazhe t'i keni marrë ju, të nderuar Gjykatës.

11 Ne i kemi njoftuar të gjithë se ka patur problem në këtë
12 drejtim. Javën e shkuar do të mbahej një takim i këtij
13 komisioni për një nga anëtarët e tij. Ka patur një emergjencë
14 familjare dhe unë personalisht i dërgoj urimet më të mira
15 këtij personi. Nuk e di për kë bëhet fjalë dhe shpresoj që të
16 mos ishte një situatë e vështirë. Dhe unë kërkoja se kur do të
17 mbahej ky takim dhe kur do të miratoheshin fondet, kjo ishte
18 kërkesa tjetër.

19 Dhe në atë dhe kur ju dërgova juve, të nderuar Gjykatës,
20 kërkesën për ta vonuar çështjen me një muaj, nuk kisha marrë
21 asnjë konfirmim lidhur me financimet. Unë e di i nderuar
22 Gjykatës, ju dëshironi të përqendroheni në respektimin e të
23 drejtave të të akuzuarit për gjykim të drejtë me qëllim që ata
24 të jenë në një situatë të barabartë me palët e tjera dhe të
25 kenë përfaqësimin e duhur. Dhe si një përfaqësuese e lartë unë

1 i marr shumë seriozisht të drejtat e të akuzuarit.

2 Këto opinione unë ia kam kaluar Ministrisë së Drejtësisë,
3 shefit të departamentit përkatës, i cili më tha gjatë ditës së
4 djeshme që sot do të mbahej një takim i komisionit. Në emaillet
5 nga shefi i këtij departamenti, në emaillet që më ka dërguar
6 mua, më kanë thënë që e kuptojnë që situata është urgjente.

7 Nuk kemi marrë asnjëherë ndonjë email që të thotë që nuk do të
8 miratohen fondet, por më duket që ka nevojë që të takohet ky
9 komision për të na treguar se për çfarë financimi bëhet fjalë.

10 Pra, aktualisht unë nuk jam në gjendje që të flas lidhur
11 me këtë situatë të financimit. Unë shpresoj që do të mbahet
12 një takim gjatë ditës së sotme dhe shpresoj që të financohet
13 ekipi im.

14 Unë shkurtimisht mund të them kështu. Që unë nuk jam në
15 gjendje që të punësoj një folës të shqipes në ekipin tim nga
16 Kosova pasi që do të thotë që e drejta e z. Bahtijari, e
17 drejta e z. Bahtijari për përkthyes, preket. Megjithatë, Zyra
18 e Koordinimit të Ekipeve të Mbrojtjes dhe personeli i
19 paraburgimit ka ndihmuar deri më sot, por më kanë thënë që nuk
20 do të garantojnë dot praninë e një përkthyesi për të gjitha
21 takimet e mia me klientin tim.

22 Unë nuk do të them më shumë në seancë private [sipas
23 përkthimit], i nderuar Gjykatës, por jam e shqetësuar për
24 shëndetin e z. Bahtijari. Kam ngritur tre çështje të shëndetit
25 të tij, nuk ka marrë përgjigje, pavarësisht që janë treguar

1 shumë bashkëpunues. Unë dua që z. Bahtijari të ketë një
2 kontroll mjekësor për të provuar që është në gjendje
3 shëndetësore për të marrë pjesë këtu. Unë nuk kam financim as
4 për atë çështje.

5 Unë jam online sot për shkak se nuk kam financim. Unë jam
6 caktuar më datën 4 janar dhe më datën 19 kam marrë qasje në
7 sistemin *Workflow* dhe unë po punoj me shpejtësinë e duhur. Por
8 në mungesë të një ekipi dhe këtu bëhet fjalë për një çështje
9 gjyqësore për të cilën ka nevojë për një ekip, unë nuk jam në
10 gjendje ta bëj punën time, pasi unë po i përmbush detyrimet e
11 mia në një situatë shumë të pakëndshme financiare.

12 Janë një numër tjetër çështjesh dhe jam e sigurt që i
13 kuptoni ju me përvojën që keni, i nderuar Gjykatës, e kuptoni
14 se sa vështirë është që të përfaqësohet një individ pa
15 financim, kryesisht në një Gjykatë ndërkombëtare.

16 Unë do të përfundoj duke thënë që kam lexuar parashtrimet
17 fyese të Zyrës së Prokurorit të Specializuar. Në qoftë se më
18 kërkoni që të përgjigjem, unë do të përgjigjem, por unë
19 president që ato të kërkojnë falje për parashtrimin e tyre të
20 pakëndshëm. Si anëtare e nivelit të lartë të profesionit tim
21 unë i kam parasysh detyrimet e mia dhe unë mendoj që është
22 shumë fyese që dikush të akuzojë mbrojtësit në vend që të
23 respektohen të drejtat e të akuzuarit për gjykim të drejtë.

24 Unë shpresoj që z. Bahtijari, ekipi i z. Bahtijari të
25 ketë financimin e duhur me qëllim që të mund të vazhdojmë

1 punën tonë dhe të mos ketë vonesa të mëtejshme, përfshirë këtu
2 edhe çështjen e kontrollit shëndetësor për të.

3 Unë do t'ju kërkoja juve gjatë ditës së sotme që ju ta
4 pezulloni këtë Konferencë të Ecurisë së Çështjes, me qëllim
5 që Ministria e Drejtësisë t'i paraqitet, të përgjigjet në bazë
6 të kërkesës që ka bërë z. Rees dhe ne të vijmë nesër këtu ta
7 vazhdojmë konferencën dhe të kemi përditësimin e duhur.

8 Ndërkohë, mund të them që nuk është e drejtë. Ne kemi
9 nevojë për ndihmën e Trupit Gjykses me qëllim që të
10 respektohen të drejtat që ka z. Bahtijari për një gjykim të
11 drejtë.

12 Ky ishte parashtrimi që kam unë.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, Dr. Gerry.

14 Tani Mbrojtësi i z. Shala, z. Cadman.

15 Z. CADMAN: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Unë nuk dua
16 të përsëris gjërat që ka thënë z. Rees apo Dr. Gerry lidhur me
17 komunikimet tona që kemi patur me Ministrinë e Drejtësisë.
18 Edhe ne jemi të prekur në të njëjtën mënyrë.

19 Ajo që mund të them është se unë i kam premtuar z. Shala
20 se pavarësisht financimit ne do të vazhdojmë ta përfaqësojmë
21 atë. Sigurisht që kemi nevojë për një vendim nga Ministria e
22 Drejtësisë. Ne kemi diskutuar me z. Shala çështjen e sigurimit
23 të fondeve përmes Dhomave të Specializuara në qoftë se
24 Ministria e Drejtësisë nuk jep përgjigjen e duhur.

25 Por z. Shala është i paraburgosur për një periudhë prej

1 më se dy muajsh tani dhe nuk duam që të ketë edhe vonesë të
2 mëtejshme të kësaj çështjeje. Për sa i përket hetimeve
3 afatgjata që bën pala Mbrojtëse, kjo çështje do të preket
4 sigurisht nga çështja e financimit. Por po e përsëris që unë i
5 kam bërë krejtësisht të qartë z. Shala që kjo çështje, pra,
6 financimi nuk do të prekë mënyrën se si e përfaqësojmë ne në
7 këtë proces. Ne kemi detyrime të cilat do t'i përmbushim, janë
8 detyrime brenda kuadrit të Dhomave të Specializuara dhe
9 detyrimi që kam edhe si anëtar i Ekipit të Avokatëve.

10 Kaq kisha për të thënë.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Tani do t'ia jap fjalën
12 ZPS-së.

13 Do t'ia jap fjalën ZPS-së. Ishte një ngatërresë me
14 mikrofonin. Për t'u përgjigjur lidhur me kërkesën për të
15 pezulluar procedurën këtu në Gjykatë. Nuk do të diskutojmë për
16 kërkesën tuaj që keni parashtruar dje, F0173 dhe që u ngrit
17 nga Mbrojtja sot. Me këtë do të merremi përmes vendimeve me
18 shkrim dhe parashtrimit me shkrim. Thjesht lidhur me kërkesën
19 e Mbrojtjes së Bahtijarit për të pezulluar procedurën.

20 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] ZPS-ja kundërshton çdo
21 kërkesë për të pezulluar apo vonuar procedurën bazuar në këtë
22 problemin e financimit që u shtjellua sot në hollësi.

23 Mendoj që pika kryesore këtu është që kjo Gjykatë, Dhomat
24 e Specializuara, kanë një kornizë funksionale
25 gjithëpërfshirëse për të trajtuar çështjet e përfaqësimit dhe

1 të financimit. Qoftë për sa i përket ndihmës ligjore apo
2 caktimit të Avokatit, përfaqësuesit sipas detyrës zyrtare. Të
3 gjitha këto rregulla janë konceptuar dhe përbërë për të
4 siguruar vazhdimësinë në përfaqësim, përfshirë shmangien e
5 vonesave.

6 Pra, pa një informacion lidhur me mënyrën se si, nëse
7 konkretisht Zyra Administrative është përfshirë dhe është
8 angazhuar në mënyrë formale apo thjesht duke, përkundër asaj
9 që është thjesht dhënia e një njoftimi, që unë e kuptoj që
10 është bërë të paktën një herë nga palët, lidhur me çështjen
11 sot, ZPS-ja nuk sheh ndonjë arsye që ndonjë gjë duhet të
12 vonohet. Sa i takon kolegut tim, Mbrojtësi i z. Shala siç e
13 tha, detyrimet e Avokatit në këtë rrethanë dhe në rrethanat që
14 mund të dalin sipas udhëzimit, detyrimi i tyre është që të
15 plotësojnë funksionet e tyre në mënyrën që do ta bëjnë në çdo
16 kontekst tjetër.

17 Dhe ZPS-ja kundërshton, pra, kërkesën e Mbrojtësit të z.
18 Bahtijari për të vonuar procesin.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj.
20 Prokurore.

21 Dr. Gerry, a dëshironi t'i përgjigjeni Prokurores lidhur
22 me këtë pikë, konkretisht, për sa i përket vonesës së
23 procedurave?

24 ZNJ. GERRY: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] E konstatoj,
25 vërej që siç e keni, përkundër asaj që keni kërkuar ju,

1 Prokuroria nuk vetëpërbahet nga bërja e komenteve lidhur me
2 detyrimet e Avokatëve. Pra, vërej, konstatoj që Prokurorja e
3 Specializuar vazhdon t'i paraqesë këto çështje në seancë
4 publike që më duket e jashtëzakonshme dhe ofenduese.

5 Në kërkesën tonë për të pezulluar procedurën për një
6 muaj, në parashtrimin tonë, kërkojmë pra që të drejtat e z.
7 Bahtijari për një gjykim të drejtë të respektohen. Kjo
8 përfshin, kjo do të thotë që ai ka nevojë që të ketë një ekip
9 që ka të bëjë me barazinë e armëve me Prokurorinë dhe ne kemi
10 të paktën tre vetë këtu sot, e cila është e përfaqësuar nga
11 tre persona sot. Kjo kërkon që të kemi një anëtar kosovar të
12 ekipit tonë. Kam thënë dhe më herët çështjen e vlerësimit të
13 gjendjes shëndetësore të tij dhe kjo kërkon financim të
14 përshtatshëm nga Ministria e Drejtësisë në mënyrë siç e kemi
15 thënë, të cilët deri tani kanë thënë që nuk do të financojnë.

16 Dhe sugjerimi i Zyrës së Prokurorit të Specializuar,
17 sipas mendimit tim, është skandaloz. Në qasjen time si Avokate
18 dhe Mbrojtëses [E pakuptueshme] sipas detyrës zyrtare nuk,
19 është barazia e armëve ajo që është e rëndësishme.

20 Ne nuk po kërkojmë që të vonojmë procesin gjyqësor këtu.
21 Unë e përfaqësoj z. Bahtijari, por gjendja e financimit nuk e
22 lejon atë që të ketë qasje në të drejtat për një gjykim të
23 barabartë, të drejtë.

24 Dhe në këto rrethana është e qartë në parashtrimin tonë
25 se do të duhet të paktën një muaj për të zgjidhur këto

1 probleme, këto çështje. Dhe nuk është thjesht çështja për të
2 thënë: Në rregull, këtu keni disa para merreni, vazhdoni me
3 këtë. Është, bëhet fjalë pra që të sigurohemi dhe të kemi
4 garanci që kemi një vlerësim të gjendjes së tij shëndetësore,
5 kemi një ekip të përshtatshëm dhe se secili ka një detyrë të
6 caktuar për të bërë dhe që ne të përgjigjemi në mënyrë të
7 duhur parashtrimeve të paraqitura nga Zyra e Prokurorit të
8 Specializuar në vend të ofendimeve.

9 Unë kuptoj që kjo Gjykatë mund të mos pranojë që të
10 vonojë procedurën për një muaj, por në parashtrimin tim e bëj
11 të qartë se gjykimi, të drejtat për një gjykim të drejtë të
12 personit të akuzuar në këtë Gjykatë, duhet të mbrohen siç
13 duhet dhe -- nuk shkelen pra në qoftë se vonohet për një muaj.
14 Dhe në këto rrethana ne, parashtrimi jonë lidhur me,
15 parashtrimi jonë vazhdon të mbesë i njëjti, pra që është për
16 të pezulluar procedurën për një muaj. Gjatë këtij muaji
17 natyrisht ne presim që t'ju japim juve, i nderuar Gjykatës
18 dhe Zyrës Administrative dhe gjithë të tjerëve, njoftim për sa
19 i përket qëndrimit tonë lidhur me financimin, përfshirë edhe
20 takimin që do të ndodhë nesër dhe Konferencën mbi Ecurinë e
21 Çështjes nesër në qoftë se është e nevojshme.

22 [Nuk ka përkthim]

23 Pra, këto janë parashtrimet tona.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit Dr. Gerry.

25 Znj. Prokurore keni fjalën në qoftë se dëshironi të

1 kundërpërgjigjeni.

2 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Do të jem shumë e shkurtër.

3 Dua të theksoj që Avokatja përmend mekanizmin e
4 financimit që parashihet nga Udhëzimi Administrativ në
5 Ministrinë e Drejtësisë së Kosovës. Kjo është jashtë kornizës
6 së kësaj Gjykate, Dhomave të Specializuara. Ajo që nuk dëgjova
7 unë është që nuk kishte asnjë justifikim, arsye, se pse
8 Avokatja nuk është angazhuar me Zyrën Administrative për të
9 përdorur kornizën ekzistuese brenda Dhomave të Specializuara -
10 -

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Dr. Gerry do t'jua jap
12 fjalën. Do t'ju jap mundësinë që të përgjigjeni, por
13 fillimisht dëgjojmë znj. Prokurore, pastaj ju do të
14 kundërpërgjigjeni dhe se gjithë të pranishmit këtu do të kenë
15 mundësi që të dëgjojnë njëri-tjetrin.

16 ZNJ. GERRY: [Përkthim] Mund ta bëj një pyetje.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Tani nuk e keni fjalën ju.
18 Unë jam ai që vendos se kush e merr fjalën dhe kush ka të
19 drejtën të flasë. Ju do t'ju jepet mundësia të shpreheni. Tani
20 Prokurorja kërkoi fjalën, ia dhashë fjalën, i thashë asaj që
21 të jetë sa më e shkurtër. Do t'jua jap fjalën juve pastaj. Nuk
22 do të toleroj në këtë sallë gjyqi ku njerëz që flasin
23 njëkohësisht dhe askush nuk kupton asgjë. Dua të dëgjoj
24 gjithçka që secili prej jush ka për të thënë dhe nuk mund ta
25 bëj të dëgjoj këtë në qoftë se të gjithë flisni në të njëjtën

1 kohë.

2 Znj. Prokurore, vazhdoni.

3 Dhe Dr. Gerry do t'jua jap fjalën pas znj. Prokurore.

4 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Desha të përfundoj fjalinë,
5 pra kemi një kornizë tërësisht funksionale dhe përfshirëse në
6 Dhomat e Specializuara për ndihmë ligjore dhe Avokatja mund të
7 bëjë kërkesë formale pranë Zyrës Administrative e cila mund të
8 zgjedhë në një mënyrë çështjen e financimit. Ka mekanizma të
9 ndryshëm, disa mekanizma, për të zgjidhur çështjen e
10 financimit brenda kornizës së Dhomave të Specializuara pa
11 përfshirë qeverinë e Kosovës për këtë çështje.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj.
13 Prokurore.

14 Dr. Gerry, keni fjalën ju tani.

15 ZNJ. GERRY: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] E di se
16 cilat janë mekanizmat e financimit. Unë kam kuptuar që
17 financimi në këtë rast do të vinte nga Ministria e Drejtësisë.
18 Asgjë nuk na është komunikuar nga Ministria e Drejtësisë. Këto
19 procese janë aty. Prokuroria vazhdon të përsërisë ofendime
20 lidhur me mua dhe ju nuk i keni urdhëruar ata që të bëjnë këto
21 parashtrime.

22 Ne nuk po marrim parasysh këtu që çështja qëndron te të
23 drejtat për një gjykim të drejtë të z. Bahtijari. E kuptoj, i
24 kuptoj mekanizmat e financimit, cilat janë ato. Në
25 parashtrimin tim Ministria e Drejtësisë duhet të respektojë

1 detyrimet e saj. Ju duhet të udhëzoni Ministrinë e Drejtësisë
2 të përgjigjet. Ne duhet të kemi mundësinë që të shkojmë të
3 paraqesim këtë çështje para Gjykatës Kushtetuese. Dhe në qoftë
4 se këto përgjigje janë të përshtatshme, në qoftë se të gjitha
5 këto mjete ligjore dështojnë, atëherë kuptoj që ka mundësi
6 alternative të tjera.

7 Ndërkohë, klienti im, çështja e klientit tim nuk ka ecur
8 përpara deri në momentin që unë jam përfshirë në këtë dhe
9 kështu është gjendja. Duhet, na duhet një person që flet
10 shqip, pra nga Kosova, kosovar, një vlerësim i gjendjes
11 shëndetësore dhe një ekip i duhur për të përfaqësuar atë dhe
12 si rezultat i kësaj krize lidhur me financimin, të drejtat e
13 tij nuk janë respektuar, pra. Në parashtrimin tim, ky është
14 parashtrimi im, ju duhet të refuzoni argumentet e Prokurores
15 së Specializuar, Zyrës së Prokurorit të Specializuar, të cilat
16 janë një sulm ndaj Mbrojtjes fshehur shumë pak.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Rees e keni fjalën ju.

18 Z. REES: [Përkthim] Dua të adresoj, të flas për disa,
19 ashtu siç u quajtën, mendime, nga Zyra e Prokurorit të
20 Specializuar.

21 Ligji për mbrojtjen ligjore dhe mbështetja financiare për
22 peronat e akuzuar potencialë në gjykime përpara Dhomave të
23 Specializuara të Kosovës, Ligji 05/L-054 dhe Udhëzimi
24 Administrativ 08/2022, është pjesë e kornizës ligjore të
25 Republikës së Kosovës që trajton vetëm këto procedura, pra, në

1 këtë Gjykatë. Ka një mundësi alternative në rastet kur
2 financimi është i vonuar, që është skemë tjetër e menaxhuar
3 nga ekipet e Mbrojtjes.

4 Dhe pa hyrë në detaje, i nderuar Gjykatës, ne jemi ashtu
5 siç kemi qenë me vite me radhë, gjithmonë të hapur dhe kemi
6 komunikuar hapur me shefin e Zyrës së Mbrojtjes dhe të tjerët
7 që punojnë në të. Nuk do të hyj në detaje lidhur me këto
8 shkëmbime apo bisedime. Por është tërësisht e papranueshme që
9 Prokuroria të hyjë arenë në këtë mënyrë.

10 Dy skemat nuk janë si alternativa direkte, të
11 njëpasnjëshme. Ato janë plotësuese me njëra-tjetrën. Skema e
12 parë ka bazë tjetër për kriteret dhe vlerësimin se sa skema që
13 ka Zyra e Mbrojtjes këtu që është skemë më e kufizuar, me
14 zbatim më të kufizuar dhe jep mbështetje më të kufizuar, jo
15 vetëm sa i përket burimeve dhe mjeteve, por edhe kush mund të
16 ketë qasje në këtë skemë në mënyrë të duhur.

17 Të dy, ZPS-ja dhe natyrësisht dhe Zyra e Mbrojtjes dhe
18 Ministria e Drejtësisë, secili prej tyre janë organet e
19 Republikës së Kosovës. Dhe nuk është e vendit që Prokuroria të
20 përpiqet të shfrytëzojë dështimet e një organi të këtij
21 shteti, të Kosovës pra, që është Ministria e Drejtësisë në dëm
22 të këtyre tre të akuzuarve. Natyrisht, interesi im është z.
23 Januzi.

24 Dhe kjo është shkelje i pavarësisë së pretenduar të ZPS-
25 së kur ajo përpiqet të ndërhyjë në të drejtat e të akuzuarit

1 që të ketë mundësi materiale dhe kohë të duhur për të
2 përgatitur Mbrojtjen, për t'u mbrojtur përmes një Avokati të
3 pavarur të Specializuar të cilin e zgjedh vetë ai dhe askush
4 tjetër. Prokuroria nuk duhet të përfshihet në çështje për të
5 cilat ata thjesht nuk kanë të drejtë të hyjnë në to.

6 Tani, nëse ju e quani pezullim apo ndërprerje, shtyrje
7 apo siç e kemi quajtur ne në Konferencën për Ecurinë e
8 Çështjes të katërt, ne thjesht i kërkojmë Gjykatës që të
9 respektojë të drejtat e të akuzuarit. Të na jepet kohë dhe
10 mundësi materiale të duhur për t'u përgatitur, mbrojtur. Që
11 kjo të merret parasysh dhe të përfshihet në kalendarin e
12 parashikuar. Të gjithë kemi dëshirë që të arrijmë në fazën kur
13 parapërgatitjet për gjykim të bëhen, të përfundojnë në të
14 gjitha anët dhe të kalojmë në pjesën e gjykimit, por ka
15 vështirësi me të cilat përballet secila, të gjitha, përballen
16 të gjitha palët. Siç e dini dhe ju z. Gjykatës, nuk kemi hyrë
17 akoma në thelbin e Konferencës mbi Ecurinë e Çështjes,
18 Prokuroria vetë nuk ka respektuar afatet kohore që ju keni
19 caktuar me gjithë pabarazinë absolute që kanë ata për sa i
20 takon burimeve që ata kanë dhe të cilat i shfrytëzojnë.

21 Kjo ishte ajo që doja të thoja. Përsëris udhëzimin për
22 Ministria e Drejtësisë nga ju i nderuar Gjykatës, me një
23 kalendar për ta, pra për t'u kërkuar atyre që ta respektojnë
24 atë dhe të respektojnë detyrimet e tyre që burojnë nga Ligji
25 05/L-054 dhe Udhëzimi Administrativ 08/2022 në fuqi nga data,

1 që ishte në fuqi në datën 4 dhjetor 2023 në momentin kur u bë
2 kërkesa në emër të z. Januzi.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Rees.

4 Znj. Prokurore, shumë, shumë shkurtimisht ju lutem.

5 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Faleminderit, z. Gjykatës.

6 Doja të shtoja thjesht që ZPS-ja nuk kërkon që të ndërhyjë në
7 asnjë mënyrë. Ne po i bëjmë parashtrimet tona në interes të
8 përshpejtimit dhe drejtësisë së procedurës me qëllim që të
9 sigurojmë vazhdimësinë e përfaqësimit ligjor për të gjithë të
10 akuzuarit.

11 Sa i takon Udhëzimit Administrativ nga Ministria e
12 Drejtësisë, dua të theksoj se në pajtim me nenin 3-4 të Ligjit
13 tonë për Dhomat e Specializuara, nuk zbatohet për funksionet
14 dhe juridiksionet e Dhomave, DHSK-së.

15 Arsyeja për të cilën e paraqes këtë kornizën, pra,
16 gjithëpërfshirëse që ekziston në Dhomat e Specializuara është
17 për të theksuar se nuk ka arsye, pavarësisht rrethanave, që të
18 ketë ndonjë dallim në përfaqësimin apo mungesën e përfaqësimit
19 për të akuzuarit.

20 Z. REES: [Përkthim] E kuptoj, z. Gjykatës, se kemi një
21 protokoll të mirëkuptuar për parashtrimet, përgjigjet dhe
22 pastaj kundërpërgjigjet, që nuk i jep të drejtën Prokurorisë
23 për t'u ngritur gjithmonë dhe për të patur fjalën e fundit.

24 Në qoftë se lejoni, kërkoj që të kundërpërgjigjem dhe
25 pastaj mund të kalojmë në pikën tjetër.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Shkurtimisht ju lutem.

2 Z. REES: [Përkthim] Ligji relevant është ligji, po
3 përsëris, 05/L-054 dhe Udhëzimi Administrativ i Ministrisë së
4 Drejtësisë 08/2022, në fuqi në momentin e parashtrimit të
5 kërkesës më 4 dhjetor 2023. Ky legjislacion është votuar,
6 miratuar nga parlamenti i Kosovës, me instrumente zbatuese siç
7 janë autorizuar nga Ministria e drejtësisë, pra kjo merret
8 vetëm dhe vetëm me Dhomat e Specializuara të Kosovës. Me asgjë
9 tjetër.

10 Dhe mendoj, kam frikë që është edhe absurde të them që,
11 që është absurde që të sugjerohet, siç pretendon Prokuroria,
12 që ky ligj është jashtë juridiksionit të Dhomave të
13 Specializuara. Nuk i përfshin ato, pra s'ka të bëjë me to. Nuk
14 e pranojmë këtë për asnjë çast, natyrisht.

15 Tani, korniza e parashikuar në ligj, në Ligjin mbi Dhomat
16 e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe --
17 Rregulloren e Procedurës dhe Provave, janë plotësuar pastaj
18 nga pjesë të tjera nga elementë të tjerë ligjorë pra,
19 legjislacion tjetër. Për shembull konstatoj që kohët e fundit
20 ju vetë, z. Gjykatës, keni marrë një vendim, lëshuar një
21 vendim, bazuar në parashtrimin e bërë nga ZPS-ja ku ata kishin
22 të drejtë të shqyrtonin kompetencën që ekziston nën Kodin e
23 Procedurës Penale të Kosovës, i cili konkretisht nuk ishte
24 përfshirë specifikisht në Ligjin për Dhomat e Specializuara të
25 Kosovës dhe Rregulloren e Procedurës dhe Provave të Dhomave të

1 Specializuara, lidhur me arrestimet dhe procedurën që pastaj
2 vijon pas arrestit.

3 Natyrisht, kjo kornizë, korniza ligjore e Dhomave të
4 Specializuara të Kosovës inkorporon, përfshin, ligjin që është
5 krijuar nga Parlamenti i Kosovës, që thotë, mbrojtje ligjore
6 dhe mbështetje financiare për të mbuluar shpenzimet e
7 Mbrojtjes dhe angazhimi i një Avokati me përvojë dhe për çdo
8 person që akuzohet për krime në procedurat para Dhomave të
9 Specializuara të Kosovës.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Rees.

11 Nuk shoh ndonjë kërkesë për dikë që do të marrë fjalën.
12 Përpara që të kalojmë tek pika tjetër, shoh që -- kërkoj
13 ndjesë, z. Cadman. Nuk e pashë që e kishit, nuk e pashë në
14 ekran që ishte dora, kishit ngritur dorën, pra.

15 Z. CADMAN: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Edhe unë e
16 ngrita dorën.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Kërkoj ndjesë.

18 Z. CADMAN: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Vetëm për të
19 thënë që kërkesa e bërë nga z. Rees për një kërkesë ndaj
20 Ministrisë së Drejtësisë është e domosdoshme pavarësisht se
21 çfarë vendimi merret. Sigurisht që duhet që Ministria e
22 drejtësisë të dalë me vendim.

23 Znj. Prokurore jam i sigurt që e di këtë çështje, por po
24 i rikujtoj asaj se secili prej të akuzuarve që është paraqitur
25 para Trupave Gjykses këtu, të gjithë janë financuar nga

1 Ministria e Drejtësisë. Sugjerimi i ndryshëm është i
2 pavërtetë. Desha ta ngre këtë çështje. Jam i sigurt që Trupi
3 Gjykues këtu është në dijeni të kësaj çështje.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Cadman.

5 Në këtë çast unë nuk shoh kërkesa të tjera për të marrë
6 fjalën. Përpara se t'i jap fjalën Zyrës Administrative unë dua
7 ta bëj të qartë që nuk do ta bëj që kjo çështje të ngelet peng
8 e gatishmërisë së Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës për të
9 financuar ekipet e Mbrojtjes. Duhet marrë urgjentisht vendimi
10 lidhur me çështjen nëse Ministria do t'i paguajë apo jo ekipet
11 e Mbrojtjes.

12 Në qoftë se Ministria e Drejtësisë merr vendim negativ
13 apo nuk e merr vendimin në ditët në vazhdim, ne kemi një
14 kuadër ligjor. Ne kemi sistemin e ndihmës financiare ligjore e
15 cila aktivizohet në momentin kur të akuzuarit nuk janë në
16 gjendje të paguajnë për ekipet e tyre të Mbrojtjes. Në qoftë
17 se Ministria e Drejtësisë e Kosovës nuk dëshiron të
18 kontribuojë për pagesat për Mbrojtjen e të akuzuarve përpara
19 Dhomave të Specializuara të Kosovës, Mbrojtësit do të paguhet
20 ose nga i akuzuari ose përmes sistemit të ndihmës ligjore.

21 Por, siç e thanë palët Mbrojtëse, është e rëndësishme, i
22 rëndësishëm është që Ministria e Drejtësisë së Kosovës të dalë
23 me një vendim. Dhe për tani çështjen, tani fjalën do t'i jap
24 Zyrës Administrative për të treguar së pari nëse palët
25 Mbrojtëse kanë kërkuar ndihmë nga ajo në këtë çështje.

1 Z. REES: [Përkthim] A mund të flas për këtë çështje?

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Jo, nuk e keni të drejtën e
3 fjalës. Vetëm pas fjalës së Zyrës Administrative.

4 Së dyti, nëse keni patur kontakt me Ministrinë e
5 Drejtësisë së Kosovës lidhur me këtë aspekt.

6 E treta, në qoftë se nuk keni patur kontakte, a jeni në
7 gjendje që të kontaktoni Ministrinë e Drejtësisë së Kosovës
8 për të pyetur, nëse do të thoja, pra, brenda dy javëve,
9 Ministria do ta zgjidhë këtë çështje me palët Mbrojtëse dhe na
10 njoftoni lidhur me diskutimet që keni patur me Ministrinë më
11 pas.

12 Dhe e katërta, në qoftë se kjo përgjigje është negative,
13 sa shpejt dhe mund të sigurohemi që janë të përfaqësuar në
14 mënyrën e duhur të akuzuarit dhe cilat janë kushtet për këtë.

15 Përpara se të jap këtë, para se t'i jap fjalën, po i jap
16 fjalën z. Rees së pari.

17 Z. REES: [Përkthim] Faleminderit, z. Gjykatës.

18 Ju përmendët gatishmërinë e Ministrisë së Drejtësisë për
19 ta miratuar kërkesën apo jo. I nderuar Gjykatës, ju nuk besoj
20 që doni ta nxisni Ministrinë e Drejtësisë të besonte apo të
21 krijonte përshtypjen që ato janë në gjendje që t'i zbatojnë
22 apo t'i injorojnë detyrimet e tyre ligjore në varësi të
23 gatishmërisë së tyre.

24 Ligji dhe në qoftë se dëshironi mund t'jua tregoj këtë
25 ligj ju, të nderuar Gjykatës, është i qartë, fare i qartë.

1 Ligji e bën të qartë që z. Januzi ka të drejtë që t'i mbulohen
2 shpenzimet e tij juridike. Është kjo në bazë të skemës së
3 krijuar nga Ligji 05/L-054 dhe Udhëzuesi Administrativ i
4 Ministrisë së Drejtësisë 08/2022, që ishte në fuqi më 4
5 dhjetor 2023.

6 Ne thjesht po kërkojmë që Ministria të përmbushë
7 detyrimin e saj ligjor. Nuk ka zgjidhje për këtë në bazë të
8 kuadrit ligjor në të cilin funksionon. Dhe ky është ligj i
9 Kosovës dhe kjo është Gjykatë e Kosovës. Nuk kanë zgjedhje në
10 këtë drejtim.

11 Një aspekt tjetër, i nderuar Gjykatës. Ju përmendët një
12 nga ndryshimet, ndryshimet e shumta, pra një nga ndryshimet
13 mes skemës së krijuar në bazë të Ligjit 05/L-054 dhe skemës
14 rezervë që funksionon këtu. Dhe kjo është çështja e mungesës
15 së mjeteve financiare.

16 Të dy këto skema nuk janë alternative. Ato funksionojnë
17 së bashku me njëri-tjetrin dhe kërkesa e z. Januzi do të duhet
18 të miratohet pasi nuk ka zgjedhje për këtë. Ajo është detyrim
19 ligjor në bazë të ligjit të Ministrisë së -- të ligjit në
20 Kosovë. Kjo nuk është zgjedhje që mund ta bëjë Ministria e
21 Mbrojtjes [Sipas përkthimit] së Kosovës.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Nilsson, e keni fjalën.
23 Jo, Dr. Gerry së pari.

24 ZNJ. GERRY: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Unë i
25 miratoj të gjitha parashtrimet e bëra nga z. Rees. Unë jam

1 shqetësuar që i kërkon Zyrës Administrative që ta bëjë në
2 këtë forum publik parashtrimin e saj lidhur me këtë çështje.

3 Sipas mendimit tim është e vështirë që ta trajtojmë këtë
4 çështje pa marrë nga Ministria informacionin e duhur. Dhe mund
5 t'ju sugjeroja që, a mund të sugjeroja që ta pezullojmë këtë
6 seancë derisa të marrim me shkrim parashtrimin nga zyra
7 Administrative dhe ta diskutojmë me klientët tonë?

8 Unë kam një takim me klientin tim në orën 14.15 nesër dhe
9 informacionet që mund të na japë Zyra Administrative mund të
10 jenë çështje të cilat mund të, do të duhet t'i diskutoja me
11 të. Dhe sipas mendimit tim nuk do të ishte mirë që ne t'i
12 merrnim këto informacione nga Zyra Administrative kështu
13 papritur. Do të duhet të kemi paralajmërimin e duhur me qëllim
14 që të jemi në gjendje ta diskutojmë në mënyrën e duhur.

15 Unë e kam bërë kërkesën për pezullimin e seancës për një
16 periudhë një mujore dhe unë shpresoj që të respektohen palët e
17 Mbrojtjes duke u dhënë njoftimin e duhur lidhur me këtë
18 çështje. Unë i kam shkruar Zyrës Administrative, i kam
19 shpjeguar se cili është problemi dhe nuk kam marrë asnjë
20 përgjigje. Në fakt, përgjigja e vetme që mora nga ato është që
21 të mos t'i çojmë email Administratores, por ta bëjmë këtë
22 përmes Zyrës së Koordinimit të Mbrojtjes.

23 Dhe a mund t'i kërkoj atëherë juve që të mos i kërkon
24 Zyrës Administrative që ta bëjë këtë në seancë publike, por
25 t'i dërgojë informacionet me shkrim me qëllim që t'i

1 diskutojmë në një çështje, në një forum të hapur?

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Do të dëgjojmë tani Zyrën
3 Administrative dhe në qoftë se keni nevojë për kohë të
4 mëtejshme për të dhënë përgjigjen, do ta bëjmë këtë, do ta
5 vlerësojmë këtë pasi të kemi marrë parashtrimet tuaja me gojë.

6 Z. Nilsson, ju e keni fjalën.

7 Z. NILSSON: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

8 Keni ngritur katër pyetje. Do të përpiqem t'u jap
9 përgjigje.

10 Mbrojtësi i z. Bahtijari dhe Mbrojtësi i z. Januzi na
11 kanë njoftuar që ishin në procesin e sigurimit të fondeve nga
12 Ministria e Drejtësisë e Kosovës dhe kanë hasur vështirësi në
13 këtë drejtim, ju kanë njoftuar edhe juve, i nderuar Gjykatës,
14 lidhur me të njëjtën gjë. Pra, kaq komunikim kemi patur lidhur
15 me këtë aspekt.

16 Për sa i përket pyetjes së dytë që ngritët ju, i nderuar
17 Gjykatës, a ka patur kontakt me Ministrinë e Drejtësisë të
18 Kosovës në këtë çështje, përgjigja është "jo". Nuk kemi pasur
19 kontakt me to.

20 Ju pyetët nëse Zyra Administrative do të mund të vendoste
21 kontakte me Ministrinë e Drejtësisë së Kosovës. Në qoftë se
22 një gjë e tillë është ndihmesë, ne do të përpiqemi për ta
23 bërë, ne do të përpiqemi ta bëjmë këtë për të parë se cilat
24 janë problemet që mbeten. Dhe për sa i përket zgjidhjes së
25 çështjes së financimit ligjor, ndonëse më duket që nuk jemi në

1 këtë pikë tani, për nga kërkesa që kanë bërë palët Mbrojtëse,
2 megjithatë jemi të gatshëm të bëjmë çfarë të doni në qoftë se
3 ju ndihmon, të nderuar Gjykatës.

4 Për sa i përket pyetjes së katërt, se cilat janë kushtet
5 në të cilat mund të mbështeten Mbrojtësi. E kemi përmendur
6 këtë çështje. Procesi fillon me të akuzuarin, me vlerësimin e
7 mjeteve financiare të të akuzuarit përpara se DHSK-ja të
8 paraqesë kërkesën për ndihmë ligjore. Është një formular apo
9 një kërkesë, një formular i cili përfshin një deklaratë të të
10 ardhurave dhe formularë të tjerë të miratimit, autorizime të
11 ndryshme të cilat Zyra Administrative të mundet t'i verifikojë
12 të gjitha informacionet që japin të akuzuarit, që të gjitha
13 janë pjesë e rregullores së ndihmës juridike.

14 Sapo të përfundojë kërkesa, Zyra e Mbrojtjes ia dërgon
15 Administratores për të marrë vendim. Dhe para se të bëhet një
16 gjë e tillë, bëhet vlerësimi i mungesës së mjeteve financiare.
17 Pasi të përfundojë hetimi lidhur me mungesën e fondeve nga ana
18 e të akuzuarit, administratori merr vendimin lidhur me ndihmën
19 ligjore për të akuzuarin në qoftë se vendoset që i akuzuari
20 nuk ka mjete ligjore. Kjo është procedura.

21 Për sa i përket afatit kohor është pak e vështirë pasi
22 është një numër aspektesh që duhet të diskutojmë ne nga Zyra
23 Administrative, por në një farë mënyre varet edhe se sa shpejt
24 na sigurohet, të akuzuarit të sigurojnë informacionin e
25 nevojshëm për këtë çështje.

1 Ka q kisha për të thënë i nderuar Gjykatës, nëse keni
2 pyetje pasuese, jam i gatshëm.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Nilsson.

4 Tani i japim fjalën z. Cadman i cili po kërkon fjalën.

5 Z. CADMAN: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Faleminderit.

6 Siç e thashë që në fillim, ne nuk kemi kontaktuar deri më tani
7 me Zyrën Administrative për shkak se kemi, jemi marrë me
8 çështjen e sigurimit të financimit nga Ministria e Drejtësisë.
9 Kur Ministria e Drejtësisë të na refuzojë kërkesën tonë apo të
10 mos japë mbrojtjen e duhur z. Shala, atëherë ne do të bëjmë
11 parashtrimet e përshtatshme përmes Zyrës Administrative.

12 Z. Nilsson i përmendi dy të akuzuarit e tjerë. Desha ta
13 bëja të qartë që kjo është arsyeja se pse ne nuk i jemi
14 drejtuar Zyrës Administrative deri në këtë moment.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Cadman.

16 Z. Rees.

17 Z. REES: [Përkthim] Faleminderit.

18 I jam mirënjohës Zyrës Administrative për ftesën që, për
19 përgjigjen pozitive që kanë ndaj kërkesës për të folur me
20 Ministrinë e Drejtësisë por zgjidhja është e drejtpërdrejtë.
21 Ne i kërkojmë Trupit Gjykses që t'i kërkojë Ministrisë së
22 Drejtësisë së Kosovës që të përgjigjet brenda një afati të
23 shpejtë kohor që do ta përcaktoni ju, i nderuar Gjykatës dhe
24 të gjithë jemi të gatshëm dhe unë mund ta them këtu që ne
25 sidomos unë nuk dua që z. Januzi të jetë peng i tyre. Që të

1 jetë peng i zbatimit të detyrimeve ligjore të Ministrisë së
2 Drejtësisë së Kosovës dhe të Udhëzimit të tyre Administrativ
3 08/2022 në fuqi në 4 dhjetor 2023.

4 Në qoftë se refuzojnë këtë, z. Januzi është qytetar i
5 Kosovës dhe z. Januzi ka të drejtën ligjore që të kërkojë
6 përmes sistemit ligjor të respektohen të drejtat e tij. Dhe
7 për ta përshpejtuar këtë çështje, hapi i ardhshëm do të ishte
8 që ne do të kërkonim mjetin e duhur ligjor dhe ky mjet i
9 përshtatshëm do të ishte përmes Dhomës Kushtetuese të cilët do
10 të nxirrnin vendimin lidhur me detyrimet ligjore të Ministrisë
11 së Drejtësisë dhe këtë ta bënin përmes një urdhri të detyruar
12 ligjor.

13 Ne dëshirojmë që kjo çështje të zgjidhet me shpejtësinë e
14 duhur dhe në këtë pikë do t'ju kërkonim ju, të nderuar
15 Gjykatës, që në qoftë se ato e refuzojnë kërkesën në mënyrë të
16 drejtë apo refuzojnë që të zbatojnë Udhëzuesin e tyre
17 Administrativ, ne do t'i kërkonim juve që t'i përshpejtonit
18 këto çështje duke dërguar çështjen para Dhomës Kushtetuese.
19 Pra, kjo do të bënte që kjo çështje të trajtohej nga Dhoma
20 Kushtetuese sa më shpejt që të jetë e mundur. Ato munden të
21 dilnin me vendimin e duhur pasi të kenë dëgjuar argumentet dhe
22 kështu do të zgjidhet.

23 Dhe kjo është rruga që ne do t'ju kërkonim juve të
24 ndiqnit, të nderuar Gjykatës.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Rees.

1 Së pari, Dr. Gerry dhe pastaj Prokuroria.

2 Dr. Gerry, ju e keni fjalën.

3 ZNJ. GERRY: [Përmes videolidhjes] [Përkthim]

4 Faleminderit, i nderuar Gjykatës. Faleminderit Zyrës

5 Administrative për parashtrimet e saj. Unë i miratoj

6 parashtrimet e z. Rees. Unë shpresoj që të merren edhe në

7 emrin e z. Bahtijari.

8 Unë ngre edhe një çështje, një shqetësim tjetër, që Zyra

9 Administrative dhe Prokuroria me nxitjen e caktimit të një

10 Avokati dezurn apo dhe përmes parashtrimit që ka bërë Zyra e

11 Prokurorisë, bëjnë që kjo Gjykatë në fakt të jetë pjesë e

12 shkeljes së detyrimit nga Ministria e Drejtësisë.

13 Kjo është situatë, situata është: Ne nuk jemi këtu për të

14 bërë negociata. Ne bëjmë kërkesë për ndihmë ligjore. Ne nuk

15 dëshirojmë, të nderuar Gjykatës, që ju të jeni pjesë e

16 shkeljes së detyrimeve që ka Ministria e Drejtësisë së

17 Kosovës. Ministria e Drejtësisë ka detyrimin për këtë çështje

18 dhe po dhuron të drejtat e të akuzuarit për një gjykim të

19 drejtë.

20 Ne jemi të shqetësuar që të gjithë, jemi të shqetësuar që

21 të gjitha këto argumente që po dëgjojmë, në fakt, po shkelen

22 të drejtat e z. Bahtijari. Ne, siç e themi më parë, do të

23 kërkonim që ju të vepronit siç tha z. Rees dhe të merrni

24 parasysh edhe kërkesën tonë, kërkesën e z. Bahtijari për ta

25 shtyrë këtë Konferencë të Ecurisë së Çështjes, me qëllim që të

1 mund të marrim vendimin e duhur në qoftë se Ministria e
2 Drejtësisë e refuzon ndihmën ligjore.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, Dr. Gerry.

4 Znj. Prokurore keni fjalën.

5 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Desha të shfrytëzoja rastin
6 të thoja që në pajtim me rregullën 2021 [Sipas përkthimit] të
7 Rregullave të Procedurës dhe të Provave të Dhomave të
8 Specializuara, përpara se të nxjerrë një urdhër për qeverinë e
9 Kosovës një trup ligjor, një Gjykatës, do të duhet të kalonte
10 të gjitha masat e duhura, të gjitha fazat e duhura përmes
11 Zyrës Administrative.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Rees.

13 Z. REES: [Përkthim] I kërkoj, mund t'ju them, i nderuar
14 Gjykatës, që unë i kam shteruar të gjitha fazat në
15 marrëdhëniet që kam patur për të detyruar Ministrinë e
16 Drejtësisë për të respektuar ligjin.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Rees.

18 Z. Nilsson, e keni fjalën.

19 Z. NILSSON: [Përkthim] Shkurtimisht, si përgjigje ndaj
20 Mbrojtësit të z. Bahtijari. Unë do të thoja që unë nuk isha
21 duke nxitur këtë çështje, nuk ishte synimi im. Unë po u
22 përgjigja thjesht që ju, i nderuar Gjykatës, thjesht se sa
23 shpejt mund të caktohet një Mbrojtës siç kërkuat ju. Zyra
24 Administrative duhet ta bëjë të qartë nuk ka qëndrim të vetin
25 në këtë çështje.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Dr. Gerry, keni fjalën.

2 ZNJ. GERRY: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Unë s'po
3 sugjeroja fare këtë që përmendi z. Nilsson. Unë po thoja që
4 ekziston një rrezik që kemi një kombinim të qëndrimit të Zyrës
5 së Prokurorit dhe të Zyrës Administrative dhe kjo do të
6 komprometojë të gjithë qëndrimin e Gjykatës. Unë nuk isha duke
7 patur këtë synim. Ajo komenti që po bëja është që kemi dy
8 organe të shtetit të cilët po kombinojnë qëndrimin e tyre dhe
9 kjo rrezikon që të çojë në mosrespektimin e të drejtave
10 ligjore nga Ministria e Drejtësisë së Kosovës.

11 Pra, desha ta sqaroja që nuk ishte ky synimi im.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit Dr. Gerry.

13 Do të nxjerr vendimet lidhur me këtë pikë në fund të
14 konferencës për ecurinë e çështjes. Tani kalojmë tek pika e
15 radhës e rendit të ditës që ka të bëjë me Prokurorinë. Nuk dua
16 që, sepse pavarësisht vendimit tim nuk dua që Prokuroria të
17 ndalojë punën e tyre në këtë rast.

18 Do të dëshiroj të dëgjoj nga ana e Zyrës së Prokurorit të
19 Specializuar për përparimet që janë bërë sa i takon nxjerrjes
20 së materialeve dhe provave. Kam konstatuar, shënuar dhe parë
21 parashtrimet me shkrim të ZPS-së lidhur me çështjen e
22 nxjerrjes së materialeve.

23 Sa i takon rregullës 102(1)(b) materialet nga kjo
24 rregull, ZPS-ja thotë se me përjashtim të disa materialeve
25 provash shtesë të kufizuara që dalin nga hetimi që është në

1 vazhdim e sipër, ajo ka plotësuar, pra ZPS-ja, përfunduar
2 nxjerrjen e materialeve brenda afateve të caktuara në vendimin
3 kornizë mbi nxjerrjen e materialeve të datës 15 dhjetor 2023
4 dhe 19 janar 2024.

5 Sa i takon rregullës, materialeve nga rregulla 102(3)
6 ZPS- ja thotë se deri tani dy nga tre të akuzuarit, z. Shala
7 dhe z. Januzi kanë kërkuar nxjerrjen e të gjitha materialeve
8 të renditura në njoftimin e detajuar.

9 ZPS-ja parasheh sfida të kufizuara për sa i përket
10 rëndësisë së provave. Ajo tregon gjithashtu se pjesa dërrmuese
11 e materialeve nga rregulla 102(3) nuk kanë nevojë, nuk do të
12 kenë nevojë për redaktime.

13 Në fund, ZPS-ja nuk parasheh që të bëjë ndonjë kërkesë
14 sipas rregullës 107 të Rregullores.

15 Mbrojtja e Januzit thotë se në parashtrimet me shkrim
16 ZPS-ja nuk ka plotësuar, përfunduar, procesin e nxjerrjes së
17 materialeve brenda afateve të përcaktuara në vendimet kornizë
18 mbi nxjerrjen e materialeve. Po ashtu vlerëson se njoftimi
19 sipas rregullës 102(3) është i paplotë. Ftoj palët që të bëjnë
20 parashtrime shtesë lidhur me këtë pikë.

21 Dhe në fund, lidhur me kundërshtimet për pranueshmërinë e
22 ndonjë materiali prove, që është nxjerrur sipas rregullës 102
23 të Rregullores, Mbrojtja e Januzit thotë, nënvizon, se nuk
24 mund të angazhohen të premtojnë që do të jenë në gjendje të
25 bëjnë, parashtrojnë kundërshtimet e tyre brenda datës 22 mars

1 2024.

2 Mbrojtja e z. Shala thekson se -- do të jetë në gjendje
3 që të bëhet, paraqesë parashtrimet dhe kundërshtimet e tyre
4 deri të premtën 22 mars 2024, në qoftë se nuk do të ketë
5 nxjerrje të tjera sipas materialeve sipas rregullës 102.

6 Ftoj palët që të bëjnë parashtrimet e tyre mbi këtë pikë
7 dhe do të marr vendim në fund.

8 Znj. Prokurore, keni fjalën ju.

9 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] ZPS-ja ka përmbushur dhe
10 respektuar afatet e përcaktuara nga vendimet kornizë të
11 ndryshuara nga ju, z. Gjykatës, me përjashtim të materialeve
12 nga rregulla 102(1)(b) të cilat ne i kemi nënvizuar në një
13 parashtrim të protokolluar përkatës, që e kemi dorëzuar tek ju
14 dhe që kërkojmë të pranohet.

15 Nuk dua të parashikojmë më herët se sa mund të bëhet, por
16 ka elementë të hetimit që janë në vazhdim e sipër, megjithëse
17 janë jashtëzakonisht të kufizuara në veprimin e tyre dhe
18 shtrirjen e tyre të cilat janë trajtuar në vendimet e ndryshme
19 që ju keni ndërmarrë dhe kërkesat e ZPS-së. Pra ne
20 parashikojmë që të, janë pra elemente shtesë shumë të
21 kufizuar.

22 Sa i përket theksimit të kolegut tim, Avokatit të z.
23 Januzi, se nxjerrjet e materialeve të bëra nga ZPS-ja janë të
24 paplota, ne do të kërkojmë informacione shtesë për të
25 shpjeguar se në çfarë mënyre, se si janë këto, janë të

1 paplota.

2 Por, konkretisht sa i takon njoftimit sipas rregullës
3 102(3) që është dhënë, që pretendohet të jetë i paplotë apo i
4 mangët në njëfarë mënyre, në momentin që ZPS-ja u informua për
5 këtë qëndrim, kjo ka ndodhur në parashtrimet e bëra nga
6 Avokati dhe ne jemi përpjekur që të bëjmë shkëmbime *inter*
7 *partes* me palët dhe deri tani që të, nuk dhe kemi marrë një
8 lloj informacioni për të parë se ku qëndron problemi me këtë
9 defekt, apo mangësi të pretenduar. Propozimi im është që të na
10 jepet mundësia të angazhohemi drejtpërdrejt me Avokatin
11 Mbrojtës me qëllim që të gjejmë një zgjidhje të këtij problemi
12 që unë, u parashtrua para jush.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Avokat.

14 Z. REES: [Përkthim] Më duket sikur ka ndodhur më parë kjo
15 gjë. Kjo më jep përshtypjen. Prokuroria në parashtrimet e
16 këtyre pohojnë se kanë përfunduar nxjerrjen e materialeve. Në
17 fakt nuk e kanë bërë këtë gjë. Atëherë, kolegja ime e nderuar
18 thotë që e kanë përfunduar brenda afateve të përcaktuara, por
19 me përjashtim që nuk e kanë plotësuar dhe përfunduar këtë
20 proces. Ne kemi pohuar në parashtrimet tona që ata nuk e
21 kishin bërë këtë gjë dhe përgjigjja e tyre e konfirmon këtë.

22 Sa i takon natyrës së kufizuar të materialeve që janë
23 akoma në trajtim e sipër, presim të shohim. Do të shohim kur
24 të merremi me to kur Prokuroria të ketë plotësuar dhe
25 përmbushur detyrimet e tyre. Unë jam plotësisht i gatshëm që

1 të kemi takim personalisht me kolegen time dhe të shohim se si
2 mund të çojmë përpara këtë çështje në shkëmbime *inter partes*.
3 Ne jemi gjithmonë të gatshëm dhe mjafton një email që të na
4 dërgohet dhe ne jemi më se të gatshëm që të angazhohemi dhe të
5 shkëmbejmë në këtë mënyrë siç e kemi bërë dhe më parë.

6 Mund të them që sa i takon faktit që njoftimi sipas
7 rregullës 102(3) nuk është i plotë. Nuk ka mister për këtë dhe
8 nuk kuptoj se pse Prokuroria nuk e kupton që ky njoftim është
9 i paplotë, sepse ata sapo shpjeguan që hetimet vazhdojnë. Ka
10 hapa hetimorë që vazhdojnë.

11 Për shembull, s'kemi nevojë të kalojmë në seancë private,
12 do të tregohem i kujdesshëm me atë që do them. Kopjet e
13 forensikës, pra të materialeve teknologjie, për shembull, këto
14 nuk na janë dhënë dhe as nuk janë në listën e provave mbi të
15 cilat mbështetet Prokuroria dhe as nuk janë në njoftimin sipas
16 rregullës 102(3). Ka materiale të tjera që janë në zhvillim e
17 sipër, por që sigurisht do të japin materiale relevante, por
18 nuk janë bërë akoma. Fakti që këto hetime të tyre do të
19 prodhojnë materiale relevante, pra, të rëndësishme.

20 Kjo më çon, më bën që të kthehem tek Konferenca për
21 Ecurinë e Çështjes paraprake, nuk e di nëse Prokuroria e
22 kupton qëllimin e njoftimit 102(3), por duhet të kuptojmë tani
23 që çdo material i rëndësishëm, relevant, që ata e posedojnë
24 duhet të paraqitet, të jetë në njoftimin sipas rregullës
25 102(3).

1 Është e qartë sepse ata nuk kanë përmbushur detyrimet e
2 tyre lidhur me provat mbi të cilat mbështeten dhe padyshim që
3 duhet të ketë përditësime dhe lidhur me shtesat sa i takon
4 njoftimit sipas rregullës 102(3) në momentin e duhur.

5 Nëse ju, i nderuar Gjykatës, dëshironi që të flas më
6 tepër lidhur me këtë pikë të rendit të ditës?

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Jo.

8 Z. REES: [Përkthim] Në qoftë se dëshironi, mund të
9 kalojmë në seancë private dhe do të jap më hollësi dhe të flas
10 për disa çështje që nuk gjenden në njoftimin sipas rregullit
11 102(3). Deri tani sa më takon mua jam, më mjafton që
12 Prokuroria të pranojë realitetin që është që nuk kanë
13 përmbushur detyrimet e tyre për nxjerrjen e provave dhe hapat
14 hetimorë në vazhdimësi dhe që duhet të japim përditësime të
15 tjera lidhur me njoftimin 102(3).

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] E kuptoj për çfarë e keni
17 fjalën, megjithatë do të pyes Prokurorinë.

18 Znj. Prokurore, dëshironi të kalojmë në seancë private në
19 mënyrë që Mbrojtja e Januzit t'ju sqarojë materialin e provave
20 në hollësi?

21 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Nuk do të preferoja që të
22 hyjmë në hollësi lidhur me masat hetimore në vazhdim e sipër.
23 Këto janë çështje që janë në zhvillim e sipër për të cilat ne
24 nuk, ne nuk dimë se çfarë materiali prove do të dalë nga këto,
25 hapat që po ndërmarrim.

1 Ajo që do të them megjithatë është që fakti që ka aspekte
2 në zhvillim e sipër të këtij hetimi, janë gjëra që ZPS-ja i ka
3 trajtuar në çdo seancë të Konferencës për Ecurinë e Çështjes.
4 Kur them që nxjerrja e materialeve është përfunduar dhe është
5 e plotë, natyrisht e kam fjalën për dokumentet që, materialet
6 që kemi, që ne posedojmë. Dhe ndërsa për sa i përket hetimeve
7 në zhvillim e sipër është e qartë që do ketë materiale të
8 tjera që do vijnë.

9 Sa i përket njoftimit sipas rregullës 102(3), kjo është
10 në zhvillim e sipër. Dhe në qoftë se ka materiale prove
11 shtesë, që vijnë në posedim të ZPS-së, natyrisht këto
12 materiale do t'i shtohen këtij dokumenti.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit znj.
14 Prokurore.

15 Tani i drejtohem Dr. Gerry.

16 ZNJ. GERRY: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Së pari nuk
17 e di a e kuptoj përgjigjen, kundërpërgjigjen e Prokurorisë që
18 thotë që njoftimi është i plotë, por i paplotë, kështu që uroj
19 që ju të jeni në gjendje ta kuptoni më mirë atë që po përpiqet
20 të thotë.

21 Në emër të z. Januzi ne kërkojmë nxjerrjen e të gjitha
22 materialeve. Kërkojmë që njoftimet të jenë të plota, por kam
23 probleme që kam dhe nuk të veproj, veprimet e mia kushtëzohen
24 nga ato. Nuk kam fonde, nuk kam ekip, nuk kam shqipfolës nga
25 Kosova. Nuk kam vlerësim të gjendjes shëndetësore, nuk kam

1 materiale të printuara. Dhe jam e shqetësuar për gjendjen e
2 tij shëndetësore nëse është në gjendje, pra, që të marrë pjesë
3 në gjykim. Dhe nuk mund, nuk jam në gjendje, sepse është
4 absolutisht e pamundur për mua që t'i përmbahem kësaj date,
5 këtij afati kohor, pra, që është 22 marsi për t'u përgjigjur
6 kërkesës tuaj. Do të kërkoja thjesht që kjo datë të kalohet,
7 të ndërrohet dhe të vihet data 22 prill si datë e propozuar e
8 Konferencës për Ecurinë e Çështjes dhe të shohim se si kemi
9 ecur më tej pastaj.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj. Gerry.

11 Z. Cadman.

12 Z. CADMAN: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Në
13 parashtrimet tona me shkrim, qëndrimi im varet nga nxjerrjet e
14 ardhshme të materialeve që do të burojnë teorikisht nga
15 hetimet në zhvillim e sipër.

16 Në një moment të caktuar ju, i nderuar Gjykatës, do të
17 jeni në situatën ku duhet të udhëzoni Prokurorinë që të
18 përmbushë këto detyrime. Duke pasur parasysh gjendjen aktuale
19 mbështes edhe bashkëndaj shqetësimet e z. Rees sa i përket
20 papërshtatshmërisë të atyre që janë nxjerrë si materiale deri
21 tani dhe është çështja mbi të cilën ju do të merrni një
22 vendim, z. Gjykatës, natyrisht.

23 E vetmja gjë që dua të nënvizoj këtu që në këtë fazë
24 është që të vihet në njoftimin e ZPS-së, të vihen objekti,
25 pra. Si në formën e një parashtrimi të protokolluar për sa i

1 përket kërkesës më të fundit të datës 9 shkurt. Natyrisht, por
2 nuk do të shkoj, nuk do të hyj në hollësi për sa i përket
3 kundërshtimeve që do kemi në këtë fazë.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Cadman.

5 Znj. Prokurore, dëshironi të përgjigjeni parashtrimeve të
6 Mbrojtjes së z. Bahtijari dhe Shala?

7 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Nuk kam asgjë për të shtuar,
8 duke marrë parasysh atë që kemi thënë deri tani.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj.
10 Prokurore.

11 Dëshiroj t'ju rikujtoj palëve thjesht se në qoftë se
12 ndonjë nga ekipet e Mbrojtëse kërkon të shtojë materiale prove
13 në njoftimin sipas rregullës 102(3) mund ta trajtoni këtë
14 çështje në fillim në formë *inter partes* me Prokurorinë.

15 Z. REES: [Përkthim] Kam një çështje që dua ta trajtoj në
16 këtë fazë që besoj që do të jetë e dobishme.

17 Ndoshta ju kujtohet, z. Gjykatës, në konferencën e parë
18 kur kam qenë këtu, nuk ka qenë e para, e para, ka qenë e dyta
19 më duket. Dhe ngrita para jush, z. Gjykatës, çështjen e
20 sigurimit të provave të mundshme dhe në seancë private, e kemi
21 bërë këtë në seancë private. Dhe ju udhëzuat, z. Gjykatës,
22 Prokurorinë, nëse ata, pra, shqyrtoat faktin nëse do të
23 merrnin hapa vetë. Dhe ata kanë ndërmarrë hapa vetë, pas kësaj
24 -- bërë një kërkesë për autoritetin për të siguruar këto
25 prova.

1 Do t'ju jap numrin e kërkesës që kanë parashtruar ata, që
2 është F00143.

3 E kanë bërë këtë kërkesë më 5 janar 2024. Me sa kam dijeni
4 nuk e kam pa akoma vendimin tuaj lidhur me atë kërkesë. Është
5 e pakundërshtuar si kërkesë sepse ne kërkuam, i shtymë që kjo
6 kërkesë të bëhej. Por a mund t'i kërkoja Gjykatës, juve z.
7 Gjykatës, që të nxirrni një vendim mbi këtë kërkesë? Kemi
8 kërkuar nga ana e Prokurorisë që të bëni, parashtroni këtë
9 kërkesë dhe presim një vendim.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] E kam marrë në fakt këtë
11 kërkesë dhe vendimi do të dalë shumë shpejt lidhur me këtë
12 çështje të ngritur nga Prokuroria, sepse në fakt ju e ngritët
13 këtë çështje në Konferencën e dytë për Ecurinë e Çështjes. E
14 kam parasysh këtë gjë.

15 Vërej se disa nga ekipet Mbrojtëse thanë që data 22 mars
16 është e mundur, të paktën një ekip Mbrojtës. Një tjetër tha që
17 ishte e parakohshme.

18 Znj. Gerry sapo theksoi një muaj më vonë, në qoftë se ke,
19 me kusht që të kemi një Konferencë për Ecurinë e Çështjes në
20 mes të këtyre datave për të zgjidhur çështjen e financimit të
21 ekipeve Mbrojtëse, në qoftë se është e mundur.

22 Dhe tani po ju pyes hapur që kjo çështje të ecë përpara.
23 Në qoftë se e shtyj afatin për një muaj, nga parashikimi
24 fillestar, që i bie më 22 prill me kusht që të mbajmë një
25 Konferencë mbi Ecurinë e Çështjes për t'u siguruar që çështja

1 e financimit është zgjidhur, a do të ishte e mundur për tre
2 ekipet Mbrojtëse që kjo datë të jetë e përshtatshme?

3 Le të fillojmë me z. Rees, pastaj Dr. Gerry, pastaj z.
4 Cadman.

5 Z. REES: [Përkthim] Ju falënderoj për ofertën për
6 shtyrjen për një muaj të këtij afati. Nëse më lejoni do të
7 them kështu. Ne do të punojmë sa më shumë dhe sa më shpejt që
8 të kemi mundësi për t'u respektuar afatet kohore që keni
9 caktuar. Nëse caktoni datën 22 prill, ne do bëjmë të gjitha
10 përpjekjet për të përmbushur këto afate. Në qoftë se ka ndonjë
11 problem ndërkohë do t'i paraqesim ato probleme ose përmes
12 parashtrimit të protokolluar ose gjatë Konferencës mbi Ecurinë
13 e Çështjes.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Rees.

15 Znj. [E padëgjueshme].

16 ZNJ. GERRY: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Unë,
17 parashtrimet e mia ishin në fakt, e dhashë këtë datë pa ditur
18 as se çfarë dite i bie. Uroj në emër të z. Bahtijari që të
19 marrim pohimin nga Ministria e Drejtësisë, miratimin e
20 financimit, domethënë gjithçka mund të ndodhë. Në qoftë se
21 mund të kemi këtë datë, thjesht nuk jam në gjendje që t'ju bëj
22 asnjë premtim, sepse është një, në rrethanat e vështira në të
23 cilat gjendemi tani. Uroj që të shkojnë gjërat mirë.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] E kuptoj plotësisht
25 gjendjen, situatën në të cilën jeni ju. Thjesht po përpiqem të

1 gjej zgjidhje.

2 Z. Cadman, ju lutem.

3 Z. CADMAN: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Ju i keni
4 parashtrimet e mia lidhur me datën paraprake që kishit caktuar
5 paraprakisht. Thjesht ritheksoj se udhëzimet që kam marrë nga
6 z. Shala janë që ai është në paraburgim. Nuk dëshiron që kjo
7 të zgjasë pafundësisht. Dhe një shtyrje një mujore nuk është e
8 paarsyeshme, megjithatë.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Cadman.

10 Nuk shoh ndonjë kërkesë, ndonjë palë që kërkon që të
11 marrë fjalën lidhur me këtë pikë.

12 Ka vetëm një aspekt të fundit mbi këtë çështje. Në
13 parashtrimin e protokolluar F00164 të dërguar dje në mëngjes,
14 ZPS-ja kërkoi që të nxirrte disa materiale të kufizuara
15 provuese në pajtim me rregullën 102(1)(b) të Rregullores. Këto
16 materiale shtesë janë një imazheri mjekoligjore e një telefoni
17 të marrë nga z. Shala dhe disa pjesë të teksteve të dërguara
18 apo të telefonatave që janë marrë nga telefoni.

19 Sipas ZPS-së, analiza e telefonit të Shalës që ka
20 siguruar këto materiale shtesë nuk është përfunduar më 15
21 dhjetor 2023 që ishte dhe afati për nxjerrjen në pajtim me
22 rregullën 102(1)(b) të Rregullores.

23 ZPS-ja thotë që këto materiale janë të kufizuara. Kanë të
24 bëjnë me materiale të cilat janë provuese sa i takon akuzave
25 dhe nxjerrja në kohën e duhur do të bënte të mundur

1 përgatitjen në kohë nga ana e Mbrojtjes.

2 Dhe ZPS-ja ka thënë që këto materiale janë pjesë të
3 listës së materialit 168 deri 170, në pritje të vendimit tim.

4 I kërkoj ZPS-së që të bëjë parashtrim lidhur me këtë
5 çështje pasi bëhet fjalë për materiale të cilat janë me vlerë
6 për sa i përket përgatitjes që duhet të bëjnë ekipet e
7 Mbrojtjes.

8 Znj. Prokurore, keni fjalën.

9 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, unë do
10 t'i përmbahem parashtrimin me shkrim të dosjes së protokolluar
11 164, paragrafi 5 dhe 6. Ne do t'i shtojmë këtyre materialeve,
12 janë materiale që janë të pritshme. Dhe që prisnim që t'i
13 siguronim dhe të cilat do t'ia nxjerrnim Mbrojtjes pasi të
14 kishim parë nëse kanë vlerë materiale.

15 Dhe pas kësaj analize, ne kemi gjetur informacion që
16 besojmë që duhet të nxirret në pajtim me rregullën 102(1)(b)
17 dhe ky do të ishte materiali i cili do t'i shfrytëzonte, do të
18 jetë me vlerë për përgatitjet e Mbrojtjes.

19 Në qoftë se ju i nderuar Gjykatës keni ndonjë pyetje, do
20 të isha e lumtur t'i jepja përgjigje.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj.

22 Prokurore.

23 Do t'i jap fjalën palës Mbrojtëse lidhur me këtë kërkesë
24 të Prokurorisë.

25 Z. Rees.

1 Z. REES: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, nuk kam
2 parashtrim për të bërë.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Rees.
4 Dr. Gerry?

5 ZNJ. GERRY: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Jo
6 faleminderit.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.
8 Z. Cadman?

9 Z. CADMAN: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Ky ishte edhe
10 parashtrimi i protokolluar që përmenda para ca kohësh, për të
11 cilin do të paraqesim kundërshtimet tona.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Cadman.
13 Tani të kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës që ka
14 të bëjë me ZPS-në që ka të bëjë me ecurinë e hetimeve të ZPS-
15 së.

16 Vërej që ZPS-ja e ka dërguar dosjen paraprake të Çështjes
17 10 në 2 shkurt të 2024, përpara vendimit të bashkimit të
18 çështjeve dhe ky ishte në përputhje me afatet që kisha
19 urdhëruar unë. Unë vërej po kështu që gjatë ditës së djeshme
20 ato paraqitën edhe tabelën në pajtim me rregullën 109(6) dhe
21 listën e provave në kërkesën në përputhje me rregullën
22 101(2) (b) [Sipas përkthimit].

23 Në parashtrimet me shkrim ZPS-ja ka thënë që do të jetë
24 në gjendje që ta dorëzojë dosjen paraprake të përditësuar
25 gjatë kësaj jave, duke vënë re që vetëm një numër i vogël

1 ndryshimesh kërkohen nga ajo që është paraqitur në më parë dhe
2 kjo për të reflektuar bashkimin e dy çështjeve gjyqësore. ZPS-
3 ja thotë që mbeten vetëm disa hapa për t'u ndërmarrë të cilët
4 do t'i bëjë sa më shpejt që të jetë e mundur.

5 Znj. Prokurore, a dëshironi të shtoni ndonjë gjë
6 parashtrimeve me shkrim që keni bërë lidhur me këtë aspekt?

7 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Jo, i nderuar Gjykatës. Unë
8 dua të nënvizoj që në qoftë se ka nevojë për hollësi të
9 mëtejshme, në qoftë se kërkohen hollësi të mëtejshme, do të
10 kërkoja që të kalonim në seancë private.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj.
12 Prokurore.

13 I kaloj tani, t'ia kaloj fjalën palës Mbrojtëse.

14 Z. Rees.

15 Z. REES: [Përkthim] Nuk kam parashtrime të tjera përveç
16 atyre që kam bërë me shkrim.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Rees.

18 Dr. Gerry.

19 ZNJ. GERRY: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Parashtrimet
20 mbeten të njëjta. Unë do të përpiqem që t'i përmbush
21 angazhimet e mia, por kam kufizime të mëdha.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, Dr. Gerry.

23 Z. Cadman.

24 Z. CADMAN: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Nuk kam asgjë
25 për të shtuar i nderuar Gjykatës.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Cadman.

2 Shoh që kemi arritur në orën 11.30, që është edhe momenti
3 i duhur për të marrë pushimin për përkthyesit, do të bëjmë një
4 pushim 25 minuta -- në fakt 30 minuta dhe të takohemi sërish
5 në orën 12.00 për të mbajtur një seancë mjaft të shkurtër.
6 Faleminderit.

7 --- Pauza fillon në orën 11.30

8 --- Seanca rifillon në orën 12.00

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Kthehemi në seancën tjetër
10 të Konferencës mbi Ecurinë e Çështjes.

11 Në pikën tjetër do t'i kthehem së pari Mbrojtjes pasi ka
12 të bëjë me vlerësimet e tyre.

13 Në urdhrin për këtë Konferencë kemi paraqitur ecurinë e
14 hetimeve të Mbrojtjes, nëse ka njoftim për alibi dhe nëse
15 dëshiron, e treta [fonetikusht] që nëse kërkesa mbi mundësitë
16 hetuese unike dhe nëse dëshironi të paraqisni dosje paraprake.

17 E di që të gjitha palët e Mbrojtjes mund të mos jenë në
18 gjendje që të paraqesin parashtrimet me shkrim gjatë ditës së
19 sotme, megjithatë po i jap Mbrojtjes fjalën për t'i kërkuar
20 nëse dëshiron të bëjnë ndonjë parashtrim gojor apo nëse duan
21 të pyesin derisa të zgjidhet çështja e financimit.

22 Po e fillojmë së pari me z. Rees.

23 Z. REES: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, ju e dini se
24 qëndrimi ynë është se derisa të zgjidhet çështja e financimit
25 nuk mund të paraqesim afate. Për sa i përket paragrafit

1 4(a) (1) dhe paragrafit numër (ii) që ka të bëjë me alibinë apo
2 me arsyet për përjashtimin e përgjegjësisë si dhe e treta mbi
3 mundësitë hetuese unike, unë do të kërkoja që të prisnim deri
4 në Konferencën tjetër mbi Ecurinë e Çështjes në të cilën do të
5 jemi në gjendje të ndihmojmë duke bërë parashikimet e duhura
6 lidhur me çështjen.

7 Për sa i përket dosjes paraprahe, mund të thoja që ne do
8 të paraqesim një dosje të tillë së bashku me materialet
9 shoqëruese sipas rregullës 95(5). Kemi thënë që ne nuk jemi në
10 gjendje që të pretojmë ta bëjmë këtë më datën 12 prill 2024
11 për shkak të situatës aktuale. Kjo është, unë vërej që kjo
12 datë është më, datë më e afërt se sa data e 22 prillit në të
13 cilën ju na kërkuat, i nderuar Gjykatës, që të paraqisnim edhe
14 kundërshtimet tona lidhur me pranueshmërinë e materialeve
15 gjatë kësaj seance.

16 Për sa i përket aspekteve të tjera, për të qenë
17 konstruktivë siç dëshironi që të jemi, i nderuar Gjykatës, në
18 qoftë se ju do të paraqisni, do të na jepni një datë të
19 fillimit të qershorit për paraqitjen e dosjes paraprahe, unë
20 nuk do të kisha kundërshtime me këtë, të nderuar Gjykatës.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Rees.

22 Dr. Gerry.

23 ZNJ. GERRY: [Përmes videolidhjes] [Mikrofoni çaktivizuar]

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mikrofoni, ju lutem.

25 ZNJ. GERRY: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Pas gjithë

1 këtyre viteve do të mendoni që do të ishte kollaj për të hapur
2 mikrofonin.

3 A mund të sugjeroja datën 22 qershor? Është pak më vonë
4 se sa thotë z. Rees. Unë kam edhe çështjen e kontrollit
5 mjekësor që përmend gjatë gjithë kohës dhe që do të ndikojë
6 lidhur me udhëzimin që do të marr nga klienti. Unë nuk dua ta
7 kundërshtoj, të kundërshtoj këtu Avokatin e Gjykatës, por ato
8 do t'i kishin përfunduar disa hetime më përpara se të
9 caktohesha unë në këtë rol. Ndërkohë që mua më datën 19 janar
10 më kanë dhënë të drejtën të shfrytëzoja -- sistemin Workflow
11 dhe kjo vetëm thjesht se dikush mendoi se isha burrë me emrin
12 Gerry dhe jo një grua me emrin Gerry. Dhe pra ka patur
13 probleme për t'u qasur ndaj materialeve.

14 Dhe kjo koha që kanë patur ekipet e tjera nuk i kemi
15 patur në dispozicion as unë as z. Bahtijari. Ne tani takohemi
16 rregullisht dhe tani jam në gjendje që t'i zbatoj të gjitha
17 detyrimet e mia, të bëj hetimet, të gjitha ato që më udhëzoni
18 të bëj në emrin -- e tij. Por mua do të më duhet kohë më e
19 madhe pasi kam shqetësimin që kam lidhur me gjendjen e tij
20 shëndetësore.

21 Unë jam dakord me z. Rees, por më duhet kohë më e gjatë.
22 Kjo nuk është për të penguar punën e Gjykatës, por unë po
23 tregohem më realiste dhe prandaj më lejoni të sugjeroj datën
24 22 qershor me qëllim që të kemi kohën e mjaftueshme për t'u
25 përgatitur dhe për të dorëzuar të gjitha materialet që

1 kërkojen me supozimin që do të miratohet edhe financimi. Kam
2 kontrolluar emailët, por nuk kemi asgjë nga Ministria e
3 Drejtësisë.

4 Unë kam një numër pengesash. Dua të ndihmoj Trupin
5 Gjykses dhe dua që afatet të jenë të arsyeshme.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, Dr. Gerry.
7 Z. Cadman.

8 Z. CADMAN: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Ju i keni
9 parashtrimet tona me shkrim lidhur me këtë çështje dhe mbi
10 çështje të tjera që kanë të bëjnë edhe lidhur me hetimet e
11 Mbrojtjes dhe kërkesat që do të bëjmë. Nuk dua të shtoj asgjë
12 në këtë moment. Vetëm për të thënë që në parashtrimet me
13 shkrim kemi thënë që përmbushja e afateve, parashtrimi i
14 afateve varet edhe nga aspekte të tjera si për shembull
15 përditësimi i dosjes paraprake nga Prokuroria që thanë që do
16 ta bëjnë këtë javë.

17 Ne kemi edhe çështjen e kësaj çështje gjyqësore që tani
18 është e përbashkët, por ekzistojnë dy aktakuza të veçanta. Do
19 të zgjidhet kjo çështje në një pikë të caktuar. Në këtë pikë
20 unë nuk po ngre kundërshtim për asgjë, as edhe për datat për
21 të cilat po diskutohet në fakt.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Cadman.

23 Nuk shoh kërkesa për ta marrë fjalën.

24 Të kalojmë tani në pikën tjetër që janë pikat e pajtimit
25 me aspektet juridike dhe faktike.

1 Më 5 shkurt 2024, ZPS-ja u qarkulloi të akuzuarve përmes
2 një emaili *inter partes* një listë të fakteve të dakordësuara,
3 por palët Mbrojtëse nuk ishin në gjendje që të përgjigjeshin.

4 Dua t'i rikujtoj palëve që palët nuk janë të detyruar që
5 të pajtohen lidhur me aspektet juridike përpara gjykimit.

6 Znj. Prokurore, e keni fjalën në këtë, për të folur mbi
7 këtë pikë.

8 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Unë do të mbështetem në
9 parashtrimin me shkrim dhe po përsëris në qoftë se Mbrojtësit
10 e të akuzuarit dëshirojnë që të komunikojnë me ne lidhur me
11 projektin që kemi dërguar lidhur me pikat e pajtimit mbi
12 aspektet juridike apo faktike, do të ishim të lumtur që t'i
13 bënim këto diskutime së bashku me ta.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

15 Z. Rees?

16 Z. REES: [Përkthim] Nuk kam asgjë për të shtuar.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Rees.

18 Dr. Gerry?

19 ZNJ. GERRY: [Përkthim] Unë shpresoj që të komunikojmë në
20 mënyrë të njëmendtë me Prokurorinë. Unë në fakt e pres që të
21 më kërkohet falje lidhur me parashtrim që është bërë lidhur me
22 mua. Dhe megjithatë unë do të bëj të pamundurën që të
23 bashkëpunoj me ta pavarësisht se po më fyejnë, por do të bëj
24 çdo gjë në interes të klientit tim. Me t'u tejkaluar problemi
25 që kemi, problemi i kontrollit shëndetësor, të gjitha dhe do

1 të isha e lumtur në qoftë se Prokuroria do të kërkonte ndjesë
2 në fakt sepse kështu do të ecnim më tutje.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

4 Z. Cadman?

5 Z. CADMAN: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Faleminderit,
6 i nderuar Gjykatës. Ne kemi komunikuar. Nuk e di nëse ZPS-ja e
7 ka parë emailin që kemi dërguar gjatë mëngjesit të sotëm. Ne
8 nuk kemi thënë që nuk do të komunikojmë, por thjesht nuk i
9 jemi përgjigjur kërkesës së tyre të 5 shkurtit. Ne do të jemi
10 të lumtur të bashkëpunojmë me ta, por është e rëndësishme për
11 të gjitha palët që t'i ketë diskutimet sa më shpejt të jetë e
12 mundur për këtë çështje.

13 Unë do të nënvizoja problemin që kemi patur në çështjet
14 sidomos pajtimin mbi çështjet juridike. Por aktualisht nuk
15 kemi dakordësim lidhur me të gjitha nga pikat e akuzës të
16 cilat duhen provuar. Siç e kemi diskutuar këtë me z. Rees dhe
17 kjo ka krijuar dhe probleme për të ecur më përpara. Unë do të
18 jem i hapur që ta hapim, jam i hapur që të kemi këtë diskutim.
19 Është çështje e një vendimi gjyqësor.

20 Por do të arrijmë në një farë marrëveshje.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

22 Znj. Prokurore, doni të përgjigjeni?

23 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Duhet t'i përgjigjem

24 Mbrojtjes së z. Bahtijari. Dua të them që parashtimi i

25 protokolluar nuk ishte ofendim. Nuk ishte personal. Ishte

1 bazuar mbi kornizën ligjore pranë Dhomave të Specializuara të
2 Kosovës dhe për t'i shërbyer shpejtësisë. Ne jemi të gatshëm
3 të bashkëpunojmë lidhur me çështje juridike këtu me Mbrojtësit
4 sa herë që dëshirojnë ta bëjnë një gjë të tillë.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj.
6 Prokurore.

7 Nuk shoh që dikush kërkon fjalën. Atëherë, do të kalojmë
8 në pikën e fundit të rendit të ditës, që është kalimi, pra, i
9 dosjes gjyqësore për Trupin Gjykses. Nuk do të kërkoj
10 parashtrime të hollësishme nga palët lidhur me këtë pikë,
11 sepse nuk kemi zgjidhur akoma pikën e parë që trajtuam në këtë
12 Konferencë.

13 Përveç në qoftë se dikush kërkon fjalën, kjo gjë do të
14 diskutohet dhe trajtohet në Konferencën për Ecurinë e Çështjes
15 së ardhshme.

16 Tani, pyes palët dhe Zyrën Administrative në qoftë se
17 kanë ndonjë pikë apo çështje tjetër që dëshirojnë të ngrenë
18 dhe të trajtojnë.

19 Fillojmë me Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

20 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Asgjë nga ZPS-ja.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj.
22 Prokurore.

23 Z. Rees, ju lutem.

24 Z. REES: [Përkthim] Dy çështje. Lokalet dhe mundësia për
25 konsultime përmes videolidhjes, ne kemi parashtruar këtë në

1 parashtrimet me shkrim. Janë dy elementë që përbëjnë këtë
2 çështje, pra.

3 Ju kujtohet, z. Gjykatës, që para disa kohësh sistemi
4 SDIS [fonetikisht] është krijuar për të mundësuar transmetimin
5 e materialeve në formë digjitale në distancë pra, në mes të
6 klientit që është në gjendjen e paraburgimit dhe Avokatit.
7 Kemi një problem sipas nesh. Sistemi i dosjeve është plot me
8 material në njërën anë dhe megjithatë prapë se prapë duket që
9 Njësia e Menaxhimit të Njësisë së Paraburgimit duket, për z.
10 Jonuzi, nuk ka qasje në të.

11 E provova dje që të marr një laptop, pra, të shkoj te
12 Qendra e Paraburgimit dhe të shoh në qoftë se mund të gjej një
13 zgjidhje për këtë. Por për arsye të cilat i kuptoj, kjo nuk u
14 lejua dhe pse më herët ishim inkurajuar që ta bënim një gjë të
15 tillë.

16 Sidoqoftë, kërkoj që dikush në njësinë e menaxhimit të
17 gjendjes së paraburgimit të bisedojë, trajtojë këtë çështje me
18 z. Januzi dhe ose të gjejë një zgjidhje për këtë, ose të
19 vërtetojnë se çfarë po bëjnë gabim Avokati dhe klienti. Unë
20 për vete nuk e di se çfarë po ndodh.

21 GJYKATËSI GUILLLOU: [Përkthim] Nëse më lejoni, fjalën, do
22 t'i a jap fjalën Zyrës Administrative përpara se të flisni, të
23 trajtoni pikën e dytë të qëndrimit tuaj.

24 Z. Nilsson, a mund të përgjigjeni lidhur me këtë, a mund
25 të sigurohet ndihmë, Avokati dhe të akuzuarit që gjithçka të

1 funksionojë siç duhet? E keni fjalën ju.

2 Z. NILSSON: [Përkthim] Faleminderit, z. Gjykatës. Po,
3 përgjigja e shkurtër është po. Mund t'u jepet ndihmë. Tani në
4 këtë çast po dëgjoj për këtë problem për herë të parë dhe do
5 të jemi në kontakt me Zyrën Administrative për të ndihmuar me
6 këtë.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Rees, fjalën e keni ju,
8 për çështjen e dytë, pikën e dytë.

9 Z. REES: [Përkthim] Çështja e dytë ka të bëjë, kthehemi
10 mbrapsht te një pikë që e kam ngritur në fund të seancës për
11 Konferencën për Ecurinë e Çështjes, që ka të bëjë me hapësirën
12 fizike, një dhomë pra, për t'u konsultuar në Qendrën e
13 Paraburgimit.

14 Konkretisht në dy konsultimet ligjore që janë bërë përmes
15 videolidhjes, z. Januzi u vendos përballë një WC-je, që neve
16 na duket, ne e konsiderojmë poshtëruese dhe nënçmuese. Diçka e
17 tillë nuk do të ndodhë, pra një konsultim ligjor me Avokatin
18 nuk duhet të ndodhë përballë, ku klienti ulet përballë
19 tualetit. Kjo është gjë që ka ndodhur kohëve të fundit dhe nuk
20 ka ndodhur deri në fillim të këtij viti. Unë s'e kam parë
21 kurrë një gjë të tillë të ndodhë askund tjetër dhe sigurisht
22 që jo aq më pak në Dhomat e Specializuara të Kosovës.

23 Të vendosësh z. Januzi në këtë vend për një konsultim
24 ligjor me Avokatin e tij është poshtëruese dhe nënçmuese dhe
25 nuk duhet të ndodhë më.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Rees.

2 I japim fjalën Zyrës Administrative. A jeni në dijeni ju
3 për këtë çështje dhe cilat janë zgjidhjet që mund të ofrohen,
4 në mënyrë që të mos ndodhë më kjo gjë.

5 Z. NILSSON: [Përkthim] Edhe këtë e dëgjoj për herë të
6 parë tani dhe nuk ka asnjë pengesë që Avokati të na kontaktojë
7 ne dhe paraprkisht për të trajtuar këto çështje të cilat
8 besoj që do zgjidhen pa asnjë vështirësi.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Nilsson.
10 Ju ftoj atëherë që të vazhdoni bisedimet me z. Rees që të
11 sigurohemi që ky problem nuk paraqitet përsëri.

12 Z. Rees, keni ndonjë parashtrim shtesë?

13 Z. REES: [Përkthim] Më duket e habitshme dhe e
14 jashtëzakonshme që askujt s'i ka shkuar në mendje që nuk është
15 vendi që z. Januzi të vendoset në këtë vend për konsultim
16 ligjor. Megjithatë, mirëpres angazhimin e z. Nilsson që kjo
17 s'do të ndodhë më. Dhe padyshim jo vetëm lidhur me këtë pikë,
18 por në përgjithësi sa i përket Qendrës së Paraburgimit duhet
19 të merren masat e nevojshme për t'u siguruar që ata që,
20 personat që mbahen të ndaluar në Qendrën e Paraburgimit të mos
21 trajtohen në mënyrë nënçmuese dhe poshtëruese.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Rees.

23 Dr. Gerry keni ndonjë parashtrim?

24 ZNJ. GERRY: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Jo, nuk kam.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Cadman.

1 Z. CADMAN: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Një pikë që e
2 kemi vënë edhe në parashtrimet me shkrim dhe nuk është
3 trajtuar akoma. Ishte pika që kishte të bënte me përkthimet që
4 Prokuroria duhet të bënte dhe ndaj të cilës nuk janë
5 përgjigjur akoma. Thjesht po ritheksoj këtë praktikë.

6 Ka një praktikë në Dhomat e Specializuara që, është që
7 dorëzojnë te të akuzuarit materialet e Gjykatës në kohën e
8 duhur kur paraqiten në Gjykatë. Thjesht i rikujtoj vetes tonë
9 dhe të gjithëve këtu që kjo është institucion vendor i
10 Republikës së Kosovës. Z. Shala është qytetar i Republikës së
11 Kosovës, nuk di anglisht dhe atë material duhet ta ketë në
12 gjuhën që kupton. Dhe kërkesa jonë është që të gjitha
13 materialet, për aq sa të jetë e mundur, duhet t'i sigurohen
14 atij dhe t'i jepen atij në gjuhën që e kupton.

15 Dhe ju -- e dini, z. Gjykatës, që në rastin e Haradinajt
16 dhe Gucatit vazhdojmë akoma tani të marrim dokumente,
17 materiale që përkthehen, që janë përkthyer gjatë gjykimit.

18 Po paraqes këtë pikë si shqetësim i përgjithshëm që Zyra
19 Administrative duhet ta trajtojë me kujdes. Nuk jemi në një
20 gjykatë ndërkombëtare, kjo është gjykatë vendore dhe kanë të
21 drejtën që materialet të përkthehen në gjuhën që ai i kupton,
22 pra i akuzuari. Kjo është pika e parë.

23 Pika e dytë, në vijim të asaj që tha z. Rees, sa i takon
24 kushteve të përgjithshme të paraburgimit dhe kemi një
25 shqetësim të madh për sa i përket vendimeve të fundit që janë

1 marrë nga shefi i Njësisë së Paraburgimit. Duke kufizuar
2 vizitat familjare në dhjetë ditë për muaj. Kemi një procedurë
3 përmes të cilës kemi bërë një ankesë zyrtare, formale me
4 shefin, pranë shefit të Njësisë së Paraburgimit dhe që do të
5 përfundojë tek ju.

6 Dua të rikujtoj këtu që z. Shala është i akuzuar, nuk
7 është i dënuar. Nuk po vuan dënim. Dhe këto kufizime për sa u
8 takon vizitave familjare janë shkelje e nenit 8 të Konventës
9 Evropiane të Drejtave të Njeriut. Përveç në rast se merret një
10 vendim, ndoshta duhet t'ju parashtrojmë një kërkesë të re,
11 lidhur me këtë do të jemi të detyruar. Nuk bëhet fjalë për atë
12 që dikush mund, apo mund të mos ketë bërë në Qendrën e
13 Paraburgimit, që do të shkaktojë kufizime apo kufizime të të
14 drejtave të z. Shala. Ai është para nesh si njeri i cili ka të
15 drejta dhe prezumimi i pafajësisë është një nga këto. Nuk ka
16 patur konstatime kundër tij për sjellje negative në Qendrën e
17 Paraburgimit dhe të detyrosh familjen e tij që të kufizojë
18 vizitat në një periudhë dhjetë ditore në muaj është gjithmonë
19 e mundur po të kishte ndodhur një gjë e tillë. Këto ishin.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Znj. Prokurore, e keni
21 fjalën ju.

22 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Sa i përket çështjes së
23 përkthimit të ngritur nga Avokati i z. Shala, dua të them që
24 Ligji mbi Dhomat e Specializuara dhe Rregullorja e Procedurës
25 dhe Provave parasheh kushtet e përkthimit me qëllim që të

1 sigurohet një gjykim i drejtë për të gjithë të akuzuarit. Dua
2 të theksoj që lidhur me përkthimet, që duhet të përgatitim për
3 shembull për të gjitha provat, të gjitha këto janë bërë.

4 Shpeshherë duke punuar me të gjitha burimet e disponueshme në
5 ZPS dhe me afate kohore me punë të madhe jemi siguruar që këto
6 përkthime të përgatiten.

7 Pra në pajtim me ligjin dhe rregulloret nuk kemi çështje
8 që përbën shkelje të gjykimit të drejtë këtu.

9 Z. NILSSON: [Përkthim] Sa i përket përkthimeve, Avokati
10 ndoshta e kishte për materialet e provës që është përgjegjësi
11 e Zyrës së Prokurorit të Specializuar.

12 Sa u përket parashtrimeve, i kujtoj Avokatit politikën
13 për përkthimet dhe përkthimin me gojë, Udhëzimin e punës së
14 Zyrës Administrative i cili parasheh në mënyrë të hollësishme
15 prioritetet, përparësitë, për përkthim të dokumenteve të
16 ndryshme. Siç kemi bërë edhe në çështje të mëhershme,
17 mirëpresim që Mbrojtja të na kontaktojë për dokumente të
18 caktuara të cilat kërkojnë që të marrin përparësi për sa i
19 përket përkthimit.

20 Në qoftë se ka dokument konkret, specifik, të cilat janë
21 burim shqetësimi për ato, ftoj Avokatin që të na kontaktojë
22 neve. Kjo ishte për përkthimin. Sa i përket pikës së dytë të
23 ngritur lidhur me kushtet e vizitës në Qendrën e Paraburgimit,
24 siç e tha Avokati, është parashtruar një ankesë e cila ndjek
25 procedurën e saj. Nuk do komentoj më tej lidhur me këtë.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Nilsson.

2 Shoh që z. Cadman kërkoi fjalën.

3 Z. Cadman e keni fjalën ju.

4 Z. CADMAN: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Shumë
5 shkurtimisht dua t'i përgjigjem kësaj. Natyrisht referenca e
6 kornizës së këtij, përmendja e kornizës së këtij institucioni
7 nuk është argument i mjaftueshëm në qoftë se vetë kjo kornizë
8 ligjore është në shkelje të detyrimeve të tyre sipas Konventës
9 Evropiane dhe ju vetë e dini këtë, z. Gjykatës. Sa i përket
10 institucioneve shtetërore që të përgatisin, të organizojnë ata
11 vetë në një mënyrë të tillë që të jenë në përputhje me
12 detyrimet e tyre. Ata duhet të organizohen në mënyrë të tillë.

13 Pra, fakti që kjo gjendet në Udhëzimin mbi Punën, mënyrën
14 se si funksionin, është prapë se prapë në shkelje me Konventën
15 Evropiane për të Drejtat e njeriut dhe është përgjigje e
16 pamjaftueshme.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Cadman.

18 Tani do të nxjerr urdhrat gojorë lidhur me çështjet që
19 trajtuam më herët, urdhri gojor, e para është për sa i përket
20 qasjes së të drejtave dhe bashkimit të dy çështjeve.

21 Urdhri i parë gojor.

22 Pasi dëgjova palët dhe duke vlerësuar natyrën urgjente të
23 çështjes që ka të bëjë me financimin e ekipeve të Mbrojtjes,
24 urdhëroj Zyrën Administrative që të kontaktojë menjëherë në
25 mënyrë urgjente Ministrinë e Drejtësisë në Kosovë, duke

1 theksuar natyrën urgjente të kësaj çështje dhe që të
2 hulumtojnë, bëjnë kërkime lidhur me çështjen e financimit dhe
3 të shohë dhe të kërkojnë informacione shtesë lidhur me kohën
4 që pritet për afatin kohor, marrjen e vendimit të Ministrisë
5 dhe që të raportojnë lidhur me këtë deri më datë, të martën
6 20, 2024 [Sipas përkthimit].

7 Ky është urdhri i parë gojor.

8 Urdhri i dytë gojor.

9 Pasi dëgjova palët dhe duke marrë parasysh fazën e
10 procedurës në të cilën jeni, se faza e procedurës paraprake
11 është në vazhdim e sipër dhe se lënda nuk është transferuar
12 akoma tek Trupi Gjykses, konstatoj se nuk i është shkaktuar
13 dëm Mbrojtjes në këtë fazë përmes vazhdimit të procedurës.

14 Më tej, konstatoj se Zyra Administrative është ngarkuar
15 që të bisedojë me Ministrinë e Drejtësisë në Kosovë me qëllim
16 që të zgjidhë në mënyrë urgjente çështjen e financimit.

17 Për rrjedhojë, hedh poshtë kërkesën për pezullim të
18 procedurës në këtë fazë.

19 Me këtë përmbyll urdhrin gojor të dytë.

20 Tani do të nxjerr urdhrin e tretë gojor.

21 Duke patur parasysh bashkimin e Lëndës 10 dhe Lëndës 11
22 dhe ndërprerjen, dosjes së lëndës në rastin, në Çështjen 11,
23 vlerësoj të duhur që të pranoj parashtrime lidhur me të
24 drejtat e qasjes që duhet t'u jepen palëve respektive.

25 Rrjedhimisht, urdhëroj ZPS-në që të bëjë parashtrimet e

1 saj deri të martën më datë 20 shkurt 2024, në të cilat do të
2 trajtoj pikat në vijim: Një, cilat parashtrime të
3 protokolluara dhe vendime nga KSC-BC-2018-01, që nga
4 parashtrimi, dorëzimi i parashtrimit të datës 15 dhjetor 2013
5 [Sipas përkthimit] lidhur me transferimin e parashtrimeve, që
6 janë F00136 në Çështjen 10 dhe F00020 në Çështjen 11, të
7 cilat, pra, nga këto mund të vihen në dispozicion të të tre të
8 akuzuarve. Dy: cilat parashtrime aktualisht të klasifikuara si
9 konfidenciale në secilën lëndë mund të bëhen, të vihen në
10 dispozicion të tre të akuzuarve? Tre: cilat parashtrime
11 aktualisht të klasifikuara si rreptësisht konfidenciale dhe ex
12 parte në secilën prej këtyre lëndëve mund të riklasifikohen
13 dhe të vihen në dispozicion të të tre të akuzuarve? Lidhur me
14 këtë nëse ZPS-ja kundërshton riklasifikimin e këtyre
15 parashtrimeve, nëse mund të parashtrojë një version të
16 redaktuar konfidencial ose të thotë se pse kjo gjë nuk mund të
17 bëhet. Katër: cilat parashtrime të identifikuar në
18 parashtrimet e ZPS-së lidhur me riklasifikimin e parashtrimeve
19 të protokolluara në Çështjen 10, të cilat janë F00117 dhe
20 F00090, tani mund në këtë fazë të riklasifikohen.

21 Mbrojtja udhëzohet të përgjigjet parashtrimeve të ZPS-së,
22 nëse dëshiron ta bëjë këtë gjë, deri të martën 27 shkurt 2024.

23 Nuk do të ketë kundërpërgjigje.

24 Me këtë përmbyll urdhrin tim të tretë.

25 Tani do të nxjerr një urdhër të katërt gojor.

1 Pasi dëgjova palët dhe duke patur parasysh kundërshtimet
2 e Mbrojtjes lidhur me pranueshmërinë e materialeve të provave
3 të nxjerra sipas rregullës 102 të Rregullores, urdhëroj
4 Mbrojtjen që të parashtrojë kundërshtimet e tyre, në qoftë se
5 kanë, deri më datë 22 prill 2024.

6 Me këtë përmbyll urdhrin e katërt gojor timin.

7 Me këtë përfundojmë seancën e sotme publike. Seanca e
8 radhës mbi ecurinë e çështjes do të programohet në mars me
9 qëllim që çështjet të cilat u trajtuan sot në mëngjes të kenë
10 gjetur zgjidhje.

11 Falënderoj Zyrën Administrative për praninë e tyre. Si
12 zakonisht falënderoj përkthyesit, teknikët audio-vizualë dhe
13 stenografin, si dhe personelin e sigurisë për ndihmën e tyre.

14 Seanca mbyllet.

15 --- Seanca mbyllet në orën 12.30

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25